



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
**AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



# RAPORT VJETOR

## JANAR – DHJETOR 2025

*Mars 2026*

**AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)****RAPORT VJETOR****JANAR – DHJETOR 2025**

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), si organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit në Kosovë, sipas Nenit 15 të Ligjit Nr. 08/L017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, paraqet Raportin vjetor të punës për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2025 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në Komisionin Parlamentar për Legjislacion, Mandate dhe Mbikëqyrje të Agjencisë kundër Korrupsionit.

Raporti vjetor i Agjencisë për vitin 2025, pasqyron punën e Agjencisë përgjatë një viti, si dhe një analizë të veprimitarisë së Agjencisë lidhur me realizimin e aktiviteteve të bazuara në planin e performancës së vitit 2025, krahasime me vitet e kaluara dhe analiza lidhur me veprimet e parandalimit të korrupsionit që ka të bëjë me zbatimin e kornizës ligjore kundër korrupsionit.



Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Me kënaqësi paraqes para jush Raportin Vjetor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2025. Ky raport nuk është thjesht një përmbledhje statistikore – ai është një pasqyrë e qartë e përpjekjeve tona të përditshme të bazuara në mandatin tone ligjor, për të forcuar integritetin institucional, transparencën dhe besimin e qytetarëve në shtetin e së drejtës, në përputhje të plotë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025, Agjencia arriti rezultate konkrete dhe të matshme. Buxheti u ekzekutua në masën 99,35 %, duke demonstruar menaxhim rigoroz dhe efikas të fondeve publike. Procesi i deklarimit të pasurisë u krye nga 98,47 % e 12.682 subjekteve deklaruese – një normë shumë e lartë që tregon rritje të përgjegjësisë së zyrtarëve publikë. U trajtuan 174 raste të konfliktit të interesit, u pranuan dhe u hetuan administrativisht 92 sinjalizime të jashtme (rritje prej 91,7 % krahasuar me 2024), ndërsa u monitoruan dhe u përditësuan Planet e Integritetit në mbi 100 institucione.

Transformimi digjital mbeti prioritet strategjik. U lancua sistemi i ri DMSA, dhe platforma i “Raporto Korrupsionit” – të gjitha këto me standarde të larta sigurie dhe ndërveprimi me sistemet shtetërore. Këto zgjidhje moderne kanë reduktuar burokracinë, rritur transparencën dhe ulur kohën e trajtimit të rasteve.

Bashkëpunimi ndërkombëtar arriti kulmin: anëtarësimi në rrjetin evropian NEIWA, vizita studimore në Francë, Portugali, Itali dhe bashkëpunim i ngushtë me OECD, Këshillin e Evropës, OSBE-në dhe UNDP-në. Kosovën e vlerësuan si shembull rajonal në hartëzimin e rrezikut të korrupsionit dhe në mbrojtjen e sinjalizuesve.

Megjithatë, raporti identifikon edhe sfida reale. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka krijuar pasiguri juridike në trajtimin penal të mosdeklarimit të pasurisë, duke dobësuar efektin parandalues. Disa institucione ende hezitojnë të trajtojnë konfliktin e interesit në burim, duke ia drejtuar të gjitha rastet Agjencisë. Këto mangësi kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme ligjore.

Të nderuar deputetë,

Agjencia është e gatshme të vazhdojë punën me profesionalizëm të plotë. Por suksesi ynë varet edhe nga mbështetja juaj: miratimi i ndryshimeve ligjore të nevojshme, forcimi i pavarësisë institucionale dhe angazhimi i përbashkët për një Kosovë pa korrupsion. Ne kemi treguar se jemi institucion modern, digjital dhe i orientuar drejt rezultateve. Tani është momenti që Kuvendi të na mbështesë në këtë rrugë evropiane.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Me respekt,

**Yll Buleshkaj,**

Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

**PËRMBAJTJA**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
LISTA E SHKURTESAVE .....	7
<b>PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM, BUXHETI, PERSONELI DHE PROKURIMI .....</b>	<b>8</b>
<b>KORNIZA LIGJORE .....</b>	<b>8</b>
<b>BUXHETI .....</b>	<b>10</b>
<b>PERSONELI.....</b>	<b>13</b>
<b>PROKURIMI .....</b>	<b>14</b>
<b>DEKLARIMI I PASURISË .....</b>	<b>19</b>
<b>TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT.....</b>	<b>20</b>
<b>ZBATIMI I LEGJSLACIONIT KUNDËR KORRUPSIONIT, SI DHE PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I TIJ .....</b>	<b>21</b>
<b>RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA NË AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT (PROKURORI DHE GJYKATA) ...</b>	<b>22</b>
<b>INFORMATA STATISTIKORE PËR VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA .....</b>	<b>23</b>
<b>PËRFAQËSIMI I RASTEVE NË GJYKATA .....</b>	<b>23</b>
<b>PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE.....</b>	<b>24</b>
<b>DEKLARIMI SIPAS LLOJEVE.....</b>	<b>28</b>
<b>KONTROLLI I PLOTË 2025 .....</b>	<b>32</b>
<b>RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA NË PROKURORI TË SHTETIT .....</b>	<b>32</b>
<b>KONTROLLI I PASURISË .....</b>	<b>32</b>
<b>DEKLARIMI I DHURATAVE TË PRANUARA NGA INSTITUCIONET .....</b>	<b>35</b>
<b>BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE .....</b>	<b>43</b>
<b>BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONE TË HUAJA .....</b>	<b>48</b>
<b>BASHKËPUNIMI RAJONAL.....</b>	<b>50</b>
<b>AKTIVITETET MEDIATIKE .....</b>	<b>55</b>
<b>AKTIVITETET E VETËDIJËSIMIT TË PUBLIKUT .....</b>	<b>56</b>
<b>KËRKESAT PËR QASJE NË INFORMATA PUBLIKE .....</b>	<b>56</b>
<b>JAVA E INTEGRITETIT 2025.....</b>	<b>57</b>
<b>TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË JASHTËM .....</b>	<b>64</b>
<b>TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM.....</b>	<b>66</b>
<b>MËSIMET E NXJERRA DHE PRIORITETET NË TË ARDHMEN .....</b>	<b>69</b>
<b>SHTOJCA NR.2. LISTA E PJESËMARRJES NË TRAJNIME, FORUME, SEMINARE GJATË VITIT 2025 .....</b>	<b>73</b>

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2025 përmbledh veprimet lidhur me përpjekjet dhe arritjet në luftën kundër korrupsionit në të gjitha fushat e veprimtarisë së saj. Këto janë disa nga elementet kyçe të raportit:

### **Fokusimi në Parandalimin e Korrupsionit**

Agjencia përmes mekanizmave të saj të parandalimit të korrupsionit, konfliktit të interesit, deklarimit të pasurisë dhe dhuratave si dhe sinjalizimit, punën e saj e ka përqendruar kryesisht me mbikqyrjen e tyre, përmes këshillimit të institucioneve, zyrtarëve të lartë publikë, si dhe rëndësinë e parandalimit me kohë të situatave të konfliktit të interesit. Këtu përfshihet edhe organizimi i procesit të deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, si dhe pranimit të dhuratave gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, si dhe procesi i sinjalizimit. Në të gjitha këto fusha, Agjencia informon vazhdimisht dhe ofron trajnime.

### **Shqyrtimi i Kërkesave dhe Informacioneve**

Agjencia ka shqyrtuar dhe trajtuar në mënyrë të vazhdueshme kërkesa dhe informacione të adresuara nga institucionet publike, raportime anonime, si dhe kërkesa nga media dhe shoqëria civile.

### **Përkrahja Profesionale për Institucionet**

Agjencia ka ofruar përkrahje dhe ekspertizë profesionale sipas kërkesave dhe nevojave të institucioneve publike në hartimin e rregullave të brendshme lidhur me çështjet e etikës dhe integritetit, përkatësisht në hartimin e planeve të integritetit, monitorimin dhe përditësimin, si dhe raportimin lidhur me zbatimin e tyre.

### **Pasqyrimi i Punës së Agjencisë**

Raporti përmban një pasqyrë të përgjithshme të punës së kryer gjatë vitit 2025, duke përfshirë aktivitetet dhe programet e trajnimit për ngritjen e vetëdijes në lidhje me parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë realizimin e produkteve vizive dhe pranimin e trajtimit e mbi 10,000 regjistrave të deklarimit të pasurisë.

### **Zbatimi i Legjislacionit dhe Plotësimi i tij**

Raporti përshkruan veprimet e Agjencisë dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi, të cilat kanë vazhduar në efikasitetin dhe efektivitetin e procedurave të brendshme të operimit dhe kontrollit për parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë hartimin dhe aprovimin e akteve nënligjore.

**Bashkëpunimi Ndërkombëtar**

Adresimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal përmes intensifikimit të takimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, realizimit të vizitave studimore, anëtarësimeve në rrjete dhe mekanizma ndërkombëtarë, si dhe organizimit e pjesëmarrjes në trajnime dhe forume profesionale. Ky bashkëpunim ka përfshirë shkëmbimin e informacionit, përvojave dhe praktikave më të mira me institucione homologe, organizata ndërkombëtare dhe partnerë rajonalë, me synim forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e transparencës dhe avancimin e standardeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në përputhje me praktikat evropiane dhe ndërkombëtare.

**Sfidat dhe Prioritetet për të Ardhmen:**

Raporti identifikon sfidat me të cilat është përballur Agjencia gjatë vitit 2025 dhe prezanton planet dhe prioritetet për të ardhmen në luftën kundër korrupsionit.

Këto elemente paraqesin një pasqyrë të përgjithshme të përpjekjeve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit gjatë vitit 2025 dhe sfidat për të ardhmen në këtë fushë.

## LISTA E SHKURTESAVE

APK	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJTH	Gjykata Themelore
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror Zgjedhor
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LDC	Leadership and Development Consultancy
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MDA	Management Development Association
MFT	Ministria e Financave dhe Transfereve
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
OE	Operator Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSH	Prokuroria e Shtetit PTH Prokuroria Themelore
QKSPEZH	Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim
RAI	Regional Anti- Corruption Initiative
SPV	Strategjia dhe Plani i Veprimit Agjencisë kundër Korrupsionit
TI	Transparency International
UNDP	United Nations Development Program
UP	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
ZKM	Zyra e Kryeministrit

## **PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM, BUXHETI, PERSONELI DHE PROKURIMI**

### **KORNIZA LIGJORE**

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore, për parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, përcakton statusin dhe kompetencat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me shqiptimin e masave dhe sanksioneve, me synim parandalimin e korrupsionit, forcimin e integritetit dhe transparencës institucionale në Republikën e Kosovës, si dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë shtetërore.

Përgjegjësitë e Agjencisë sipas Ligjit Nr. 08/L-017 janë si në vijim:

- Zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve që përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe marrjen e masave të parapara me ligjin e veçantë; Mbikëqyrjen e deklarimit të pasurive; dhe Mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj;
- Dhënien e mendimeve lidhur me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare;
- Mbikëqyrjen dhe marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve.
- Ndërmarrjen e veprimeve në fushën e monitorimit të planit të veprimit të strategjisë nacionale kundër korrupsionit, vlerësimit kundër- korrupsion të akteve ligjore, vlerësimeve të rrezikut të korrupsionit dhe planeve të integritetit që përfshijnë:
- Dhënien e ndihmës profesionale dhe teknike, këshilla dhe mbështetje të iniciativave të cilat synohen të ndërmerren nga institucionet për parandalim të korrupsionit;
- Dhënien e rekomandimeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës mbi vlerësimin e projektligjeve që lidhen me parandalimin e korrupsionit kur kjo kërkohet nga këto institucione apo me vendim të Drejtorit të Agjencisë;
- Monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe planit të saj të veprimit;
- Bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për vetëdijësimin e publikut për parandalimin e korrupsionit;
- Zhvillimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit dhe Dhënien e opinionëve lidhur me aktet ligjore për qëllim të përafrimit me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit;
- Monitorimin e zbatimit të planit të integritetit të institucioneve publike;
- Kryerjen e hetimeve administrative dhe ndërmarrjen e veprimeve në rastet që bien në kuadër të kompetencave të Agjencisë; Referimin e kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit ose në rast të shkeljes administrative përcjelljen e rastit tek organi administrativ kompetent
- Inicimin e procedurave kundërvajtësve nga fushë veprimtaria e vet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe Shqiptimi i gjobave dhe ndërmarrjen e masave tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit gjatë vitit 2025 ka funksionuar mbi bazën e Rregullores Nr. 07/2024 për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në APK, të zëvendësuar pastaj me Rregulloren Nr. 02/2025 për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në APK, të miratuar konform Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sipas strukturës së re të brendshme organizative ([Organogrami i Agjencisë](#)).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në vitin 2025 ka funksionuar me 58 të punësuar/zyrtarë sipas strukturës së re organizative të ndara në departamente, divizione dhe njësi.

- Departamenti për Vlerësim, Monitorim dhe Analiza, i cili është përgjegjës për vlerësimin e legjislacionit në përputhje me parimet dhe standardet vendore dhe ndërkombëtare kundër korrupsionit, si dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe analizim pro aktiv të zbatimit të planeve të integritetit dhe strategjisë shtetërore kundër korrupsionit. Ky Departament është përbërë nga: 1. Divizioni Vlerësim dhe Analiza kundër Korrupsionit, dhe 2. Divizioni për Integritet dhe Strategji.
- Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, i cili është përgjegjës për sigurimin e një sistemi efektiv të deklarimit dhe të kontrollit të pasurisë së deklaruar, si dhe të deklarimit dhe inspektimit të dhuratave. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Kontrollin dhe Verifikimin e Pasurisë, 2. Divizioni për Inspektimin dhe Auditimin e Dhuratave si dhe 3. Divizioni për Deklarimin e Pasurisë dhe Shqiptimin e Gjobave.
- Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e mekanizmave, rregullatives për parandalimin e konfliktit të interesit nëpër institucione publike të vendit, pastaj këshillimin e zyrtareve të lartë publik, që rrjedhimisht i bie për forcimin e integritetit të sektorit publik dhe garantimin e kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve. Ky Departament përbëhet nga dy divizione: 1. Divizioni për Zgjidhjen e Konfliktit të Interesit dhe 2. Divizioni për Këshillim dhe Raportim.
- Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme, i cili është përgjegjës për sigurimin e njësive organizative të Agjencisë të kenë shërbime dhe mbështetje administrative efikase, e-shërbime dhe teknologji informative në mënyrë efektive. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme, dhe 2. Divizioni për E-shërbime dhe Sisteme.
- Divizioni për Buxhet dhe Financa, i cili është përgjegjës për zhvillimin e politikave, legjislacionit, dokumenteve strategjike dhe udhëzimeve në fushën e menaxhimit financiar, procedurave dhe dokumenteve lidhur me buxhetin dhe shpenzimet buxhetore, përgatitjen, menaxhimin e buxhetit dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare për të gjitha njësitë organizative të Agjencisë.
- Divizioni për Sinjalizim, i cili është përgjegjës për sigurimin e funksionimit efikas të mekanizmave të sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik, hetimin administrativ dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

- Divizioni për Përfaqësim, Standardizim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, i cili është përgjegjës për sigurimin e përfaqësimit ligjor adekuat, zbatimin efektiv të standardeve profesionale, si dhe avancimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për sigurimin e menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore, përmes zhvillimit të procedurave dhe shërbimeve të cilat kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të institucionit dhe punonjësve.
- Zyrtari i Prokurimit, i cili është përgjegjës për zhvillimin e procedurave dhe aktiviteteve të prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik.
- Zyrtari për Informim dhe Edukim, i cili është përgjegjës në organizimin, koordinimin, drejtimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve lidhur me edukimin dhe informimin e publikut dhe mediave përkritazi me punën, aktivitetet dhe veprimtarinë e Agjencisë.

## BUXHETI

Sipas Ligjit për Agjencinë: APK harton buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, si dhe vendos në mënyrë të pavarur për përdorimin e buxhetit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, Buxheti i Agjencisë për vitin 2025 ka qenë 1,099,235.00 € ,ndërsa buxheti final në fund të vitit 2025 ka qenë 1,089,943.85€. Nga buxheti final janë shpenzuar në total 1,082,919.90 €, shprehur në përqindje 99.35%.

Mjetet e ndara janë planifikuar dhe janë menaxhuar sipas obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, të cilat i kanë përmbushur nevojat reale të institucionit.

Gjatë vitit 2025, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në kuadër të periudhës raportuese të subjekteve deklaruese, ka shqiptuar gjobë administrative ndaj subjekteve të cilat kanë vonesë në deklarimin e pasurisë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave.

Si rezultat i këtyre veprimeve, të hyrat jo tatimore të realizuara nga gjobat e shqiptuara dhe të evidentuara gjatë vitit raportues kanë arritur vlerën totale prej 18,810.45 €.

Kategoritë ekonomike	Buxheti i Aprovuar (fillestar)	Ndryshimet ne Buxhet	Buxheti Final	Shpenzimet në total	% e realizimit bazuar në buxhetin final	
N r.	a	b	c	d	e=(c÷b)	
1	<b>Paga dhe Shtesa</b>	776,679.00	-9,291.15	767,387.85	767,387.85	100%
2	<b>Mallra dhe Shërbime</b>	136,556.00	-4,180.00	132,376.00	128,060.20	96.73%
3	<b>Shpenzime Kom unale</b>	6,000.00	-900.00	132,376.00	2,391.89	46.89%
4	<b>Pasurit jo financiare</b>	180,000.00	+5,080.00	185,080.00	185,079.97	100%
5	<b>Totali</b>	<b>1,099,235.00</b>	<b>-9,291.15</b>	<b>1,089,943.85</b>	<b>1,082,919.90</b>	<b>99.35%</b>
	<b>Pranimet- Të hyrat</b>	<b>18,810.45</b>				

Tabela Nr. 1 pasqyron buxhetin fillestar sipas kategorive ekonomike, buxhetin final, shpenzimet, përqindja (%) e realizimit dhe të hyrat

Bazuar në ndarjet buxhetore, pas alokimit të fondeve konform planifikimeve dhe obligimeve kontraktuale, planit të prokurimit si dhe aktiviteteve të brendshme të institucionit është përgatitur plani i rrjedhjes së parasë.

**Paga dhe Shtesa** - Ndarjet fillestare në kategorinë Paga dhe Shtesa kanë qenë në vlerën 776,679.00 €, pas ndryshimit të buxhetit sipas vendimeve të MFPT buxheti final ka qenë 767,387.00 €. Mjetet e shpenzuara kanë arritur gjithashtu 767,387.00 €, duke reflektuar një realizim të plotë në masën 100%.

Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij final ka ardhur si rezultat i dy vendimeve të Qeverisë gjatë vitit:

- Vendimi nr. 03/261, datë 05.06.2025, për shkak të rritjes së koeficientit, ka sjellë një shtesë prej 17,879.40 € mbi buxhetin fillestar.
- Vendimi nr. 01/281, në fund të vitit, ka përcaktuar tërheqjen e mjeteve të paspenzuara në vlerën 27,170.55 €, për arsye se disa pozita kanë qenë të lira gjatë pjesës së parë të vitit, ndërsa janë plotësuar në pjesën e dytë të vitit.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve, buxheti final është harmonizuar në 767,387.00 €, dhe është realizuar në tërësi.

**Mallra dhe Shërbime**- Buxheti i ndarë fillimisht në kategorinë Mallra dhe Shërbime ka qenë 136,556.00 €. Më qëllim të realizimit të nevojave institucionale, dhe me kërkesë të Agjencisë, në përputhje me Vendimin nr. 3042-3/2025 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, nga kjo kategori është transferuar shuma prej 4,180.00 € në kategorinë e Investimeve Kapitale, për realizimin e projektit kapital "Furnizim me vetura zyrtare".

Pas këtij transferimi, buxheti final i kategorisë Mallra dhe Shërbime ka qenë në 132,376.00 €. Nga ky buxhet, janë shpenzuar gjithsej 128,060.20 €, që i përgjigjet një realizimi prej 96.73%.

**Shpenzimet Komunale** - Buxheti i ndarë fillimisht në kategorinë Shpenzime Komunale ka qenë 6,000.00 €. Me qëllim të realizimit të nevojave institucionale, dhe me kërkesë të Agjencisë, në përputhje me Vendimin nr. 3042-3/2025 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është transferuar shuma prej 900.00 € në kategorinë e Investimeve Kapitale, për realizimin e projektit kapital *“Furnizim me vetura zyrtare”*.

Pas këtij transferimi, buxheti final i kategorisë Shpenzime Komunale ka qenë në 5,100.00 €, nga të cilat janë shpenzuar 2,391.89 €, që i përgjigjet një realizimi prej 46.89%.

Në këtë kategori, Agjencia ka kryer pagesën për shërbimet e telefonisë fikse, ndërsa obligimet e tjera që rrjedhin nga kjo kategori janë mbuluar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

**Investime Kapitale** – Sipas Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, buxheti fillestar i miratuar për kategorinë e Investimeve Kapitale për vitin 2025 ishte 180,000.00 €. Gjatë vitit, në këtë kategori kanë ndodhur ndryshime buxhetore si rezultat i aprovimit të kërkesave për transferim të mjeteve nga kategoritë Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzime Komunale, në vlerë totale prej 5,080.00 €, për realizimin e aktivitetit *“Furnizim me vetura zyrtare”*, në përputhje me kërkesën e Agjencisë dhe Vendimin nr. 3042-3/2025 të MFPT.

Projektet e realizuara në kuadër të kësaj kategorie janë si në vijim:

- Furnizim me vetura zyrtare për nevojat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Zhvillimi dhe implementimi i sistemit elektronik të avancuar për deklarin e pasurisë dhe menaxhimin e rasteve; dhe
- Zhvillimi i infrastrukturës digjitale për menaxhimin dhe ruajtjen e dokumenteve dhe protokollit të APK-së.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve, buxheti final në kategorinë Investime Kapitale për vitin 2025 ka qenë 185,080.00 €, ndërsa shpenzimet e realizuara kanë arritur në 185,079.97 €, duke reflektuar një realizim të plotë në masën 100.00%.

**Të Hyrat** - Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nga procesi i shqiptimit të gjobave, gjatë vitit 2025 ka realizuar të hyra në vlerë prej 18,810.45€.

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti final për vitin 2025	Shpenzimet 2025	Buxheti final për vitin 2024	Shpenzimet 2024	Buxheti final për vitin 2023	Shpenzimet 2023
		a	b	c	d	e	f
1	<b>Paga dhe Shtesa</b>	767,387.85	767,387.85	556,507.18	556,507.18	513,851.18	513,851.18
2	<b>Mallra dhe Shërbime</b>	132,376.00	128,060.20	123,466.00	112,697.66	114,056.00	101,110.04
3	<b>Shpenzime Komunale</b>	5,100.00	2,391.89	8,500.00	3,120.09	8,500.00	2,703.01
4	<b>Pasuritë jo financiare</b>	185,080.00	185,079.97	94,000.00	88,517.5	20,000.00	6,677.00
	<b>Totali</b>	<b>1,089,943.85</b>	<b>1,082,919.90</b>	<b>782,473.18</b>	<b>760,842.43</b>	<b>656,407.18</b>	<b>624,341.23</b>

Tabela Nr.2 pasqyron ndarjen ndarjen buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe shpenzimeve për periudhën 2023-2025

## PERSONELI

Gjatë vitit 2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka vazhduar aktivitetet në bazë të Ligjit Nr. 06/L 197 për Zyrtarët Publik. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka menaxhuar dhe ndihmuar lidhur me procesin e vlerësimit të zyrtarëve të Agjencisë për vitin paraprak. Është zhvilluar plani i personelit, plani i trajnimeve, si dhe janë menaxhuar të gjitha sistemeve që lidhen direkt me përgjegjësitë njësisë së burimeve njerëzore: si sistemi për menaxhimin e Burimeve Njerëzore <https://hrmis.rks-gov.net>, sistemi i Hyrje Daljeve <http://svp.rks-gov.net/>, sistemi i Arkivave <https://smaed-online.rks-gov.net/> dhe sistemi i Menaxhimit të Pagave <https://smp.rks-gov.net>.

Është bërë përditësimi i të dhënave të nevojshme për të gjitha këto sisteme, si përditësimi i të dhënave në dosjet e zyrtarëve, menaxhimi i pushimeve, raportet mujore për ditët e vijueshmërisë në punë për të gjithë, si dhe të gjitha ndryshimet që lidhen me pagat e zyrtarëve të APK-së.

Janë bërë ndryshimet e të gjitha Akteve të Emërimit si dhe vendimet në bazë të Rregullores nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në APK.

Pozita:	Kategoria	Nr. i të aplikuarve	Nr. i të emëruarve
Zyrtar i lartë i TI-së për sisteme	Profesional 1	65	1
Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme	Nivel i ulët drejtues	15	1
Zyrtar për Arkiv	Profesional 2	54	1

Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore	Profesional 1	57	1
Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa	Nivel i ulët drejtues	18	1

Tabela nr.3 Procedurat e pranimit gjatë vitit 2025

Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes së zyrtarëve të Agjencisë në trajnime, forume, seminare të ndryshme gjatë vitit 2025 shih të dhënat e listuara në: **Shtojca Nr.2. Lista e pjesëmarrjes të trajnime, forume, seminare gjatë vitit 2025.**

## PROKURIMI

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka kaluar pragun mbi 50 dhjetë punëtorë, duke marrë të drejtën të procesoj aktivitetet e prokurimit si institucion i pavarur. Aktivitetet e prokurimit të cilat janë planifikuar për vitin 2025 janë realizuar sipas Planit të Prokurimit, nga 22 aktivitete të planifikuara të prokurimit janë realizuar 15 aktivitete si procedura të hapura dhe 4 aktivitete përmes procedurës mini-tender, pra gjithsej 19 aktivitete të prokurimit. Brenda këtyre, 5 aktivitete janë anuluar dhe ri tenderuar përsëri. Kontrata të cilat janë lidhur me AQP -në dhe që kanë validitet ende vazhdojnë të jenë në fuqi, ndërsa kontratat të cilat i realizon AQP në kuadër gjitha institucioneve me Vendim të qeverisë funksionojnë njëjtë si për autoritetet tjera edhe për APK-në.

Në kuadër të aktiviteteve të prokurimit janë nxjerrje edhe urdhër blerjet nga SIMFK, si dhe janë përpunuar plane të menaxhimit të kontratave dhe menaxhimi i kontratave është bërë përmes sistemit të e-prokurimi.

## SISTEMET ELEKTRONIKE DHE DIGJITALIZIMI

Në periudhën raportuese, 1 janar 2025 deri me 31 dhjetor 2025, Agjencia ka realizuar projekte të rëndësishme në vazhdim të transformimit digjital të proceseve të punës së saj dhe në avancimin e sistemeve elektronike ekzistuese. Të gjitha projektet e zhvilluara dhe aktivitetet kryesore të punës për sisteme elektronike janë bazuar në planin e performancës së Agjencisë për vitin 2025, ku përgjegjës për menaxhimin e sistemeve elektronike, dhe transformimin digjital është divizioni për e-shërbime dhe sisteme.

### Zhvillimet Digjitale dhe Infrastruktura Teknologjike

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka realizuar një avancim të ndjeshëm në transformimin digjital të institucionit, ku janë zhvilluar dhe implementuar projekte të rëndësishme në fushën e teknologjisë informative. Projektet kyçe për digjitalizim që janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe, janë:

Zhvillimi i sistemit të ri elektronik, DMSA (Data Management System of the Agency) – Ky sistem është zhvilluar në teknologjinë e Microsoftit, në frameëorkun e vitit 2025 të Microsoft Visual. Net 8, MS SQL Server teknologjia e fundit. Sistemi është zhvilluar duke aplikuar teknologji të avancuara të sigurisë, mekanizma të shkëmbimit elektronik të të dhënave me sistemet shtetërore, enkriptim të të dhënave dhe komunikim të siguar end-to-end. Sistemi i ri DMSA, ka avancuar teknologjinë e moduleve të sistemit të mëparshëm dhe ka shtuar funksionet brenda tyre, si dhe janë zhvilluar module të reja. Modulet kryesore të këtij sistemi, janë:

- DMSA Admin, është moduli për administrimin e gjithë sistemit;
- Pikat e Kontaktit, është moduli për administrimin e zyrtarëve kontaktues në të gjitha institucionet e Kosovës, duke përfshi zyrtarët kontaktues për deklarim të pasurisë, për deklarim të dhuratave, për raporte të sinjalizimit të brendshëm, për raporte të konfliktit të interesit, për raportim të planeve të integritetit, për raportim të planeve të veprimit, dhe për vlerësim të rrezikut dhe korrupsionit (<https://pikatekontaktit.rks-gov.net>).
- E-deklarimi, është modul i deklarimit elektronik të pasurisë përmes ueb-të që mundëson deklarimin e pasurisë për secilin subjekt deklarues dhe është plotësisht responsive dhe kompatibel me të gjithë shfletuesit modernë dhe pajisjet mobile (<https://e-deklarimi.rks-gov.net>).
- DMSA Administrimi i raporteve, është modul që mundëson administrimin, aprovimin, dhe refuzimin e raporteve të zyrtarëve kontaktues për sinjalizim, konflikt të interesit, plane të integritetit, plane të veprimit, dhe monitorim dhe vlerësim të rrezikut për korrupsion.
- DMSA Raportet, mundëson gjenerimin e raporteve të ndryshme statistikore për të gjitha të dhënat që gjenden në sistem.

Zhvillimi i sistemit të ri elektronik DMSA/CMS (Data Management System of the Agency / Case Management System) – Ky sistem është zhvilluar në kuadër të projektit të njëjtë me sistemin DMSA. Ky sistem mundëson menaxhimin e rasteve të Agjencisë, përmes moduleve të veçanta, si:

- Moduli i Verifikimit dhe kontrollit të plotë së pasurisë, që mundon verifikimin elektronik të pasurisë, ndarjen e rasteve për verifikim, përgatitjen e raporteve finale të hetimit dhe dërgimin e tyre në institucione të tjera përkatëse. Gjatë procesit të verifikimit sistemi merr të dhëna nga sisteme të tjera relevante shtetërore.
- Moduli i Shqiptimit të gjobave, mundëson verifikimin automatik të mos deklarimit të pasurisë, dhe deklarimit me vonës, duke mundësuar menaxhimin e shqiptimit të gjobave dhe vërejtjeve për subjektet deklaruese dhe zyrtarët kontaktues.
- Moduli i inspektimit të dhuratave, mundëson verifikimin dhe inspektimin e dhuratave nëpër institucione.

Zhvillimi i aplikacionit mobil për modulin e deklarimit elektronik të pasurisë, e-deklarimi, është zhvilluar aplikacioni mobil për Android dhe IOS, i cili mund të përdoret nga subjektet deklaruese për të realizuar deklarimin e pasurisë në Agjenci përmes telefonit mobil.

Zhvillimi i platformës për të dhëna të hapura, “APK – OPEN DATA”, është platformë e cila është zhvilluar për publikimin e të dhënave të regjistrave të deklarimit të pasurisë edhe në formatin e hapur si Excel dhe csv file.

Avancimi i platformës “Raporto Korrupsionit”, tanimë si një platformë mjaft e përdorur nga qytetarët për raportim të korrupsionit dhe e vlerësuar nga akter relevant ndërkombëtar si një platformë cilësore dhe user friendly, duke e propozuar si model edhe për vende të tjera, është avancuar me zhvillim të

funksioneve shtesë dhe raporteve statistikore. Sponsor financiar për këtë platformë ishte projekti SAEK III, UNDP Seul. Kjo platformë përbëhet nga dy module kryesore, dhe atë:

- Raporto, që mundëson raportimin e rasteve të korrupsionit për:
  - Sinjalizim,
  - Konflikt të Interesit,
  - Mos deklarim (deklarim të rremë) të pasurisë apo dhuratave, dhe
  - Natyra të tjera.
- Raporto-CMS, mundëson trajtimin e secilit rast të raportuar nga hapi i pranimit deri te finalizimi i tij, duke marr epilog përfundimtar.

Platforma Raporto Korrupsionin, në mënyrë interaktive dhe në kohë reale njofton raportuesin për fazën në të cilin ndodhet raportimi dhe veprimet që merren nga Agjencia gjatë shqyrtimit të rastit. Ky komunikim realizohet përmes platformës duke përdorur numrin unik identifikues të rastit të raportuar.

Implementimi i projektit të infrastrukturës kritike dhe ndryshimi i domenit. Është zhvilluar dhe implementuar teknologjia e re për infrastrukturën kritike të serverëve dhe të dhënave të Agjencisë, duke kaluar në teknologjinë 'Cluster' dhe në domenin e ri apk.rks. Me këtë rast është aplikuar teknologjia e fundit për:

- Server, storage dhe backup solution, si dhe
- Të gjithë përdoruesit e Agjencisë kanë kaluar në versionin e fundit të MS Ëindoës-it dhe MS Office-të, dhe antivirusit Sophos.

Zhvillimi dhe implementimi i projektit për digjitalizim të telefonisë fikse. Në koordinim dhe më përkrahje të Agjencisë për Shërbime të Informacionit (ASHI) kemi realizuar projektin e digjitalizimit të telefonisë zyrtare fikse, duke kaluar nga sistemi analog në atë digjital, voice-over-IP (VoIP).

Web faqen e Agjencisë, <https://apk-rks.net> për ta rritur sigurinë dhe performancën për shkak të ngarkesës së madhe me të dhëna të shumta të deklarimit të pasurisë, e kemi hostuar në Cloud technology, në Microsoft Azure.

Përveç projekteve teknologjike të lartpërmendura, janë realizuar edhe disa aktivitete të tjera si blerje e pajisjeve kompjuter, laptop, dhe skaner profesional për digjitalizimin e dokumenteve arkivor të Agjencisë, që nga themelimi i saj. Për realizimin e digjitalizimit të dokumenteve të vjetra të arkivuara të Agjencisë, është realizuar edhe një projekt furnizues i dyfishimit të hapësirës ruajtje të të dhënave elektronike në server room të Agjencisë, ku kemi blerë disa disqe për storage.

Për periudhën raportuese, është realizuar me sukses edhe menaxhimi dhe administrimi i sistemeve elektronike aktuale të Agjencisë, si: DMSA dhe DMSA/CMS, SDRP (sistemi për deklarim dhe regjistrim të pasurisë), etj. Administrimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik dhe infrastrukturës, si dhe ngritja teknologjike e vazhdueshme e sistemeve operative dhe aplikacioneve për përdoruesit e Agjencisë ka

ndodhur gjatë gjithë vitit. Figura në vijim paraqet në mënyrë grafike realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të teknologjisë informative gjatë vitit 2025 sipas natyrës apo llojit. Nga zhvillimet e reja, kemi tre sisteme (DMSA, DMSA-CMS, dhe VoIP), shtatë module, tre platforma, një aplikacion mobil (e-deklarimi), dhe dy projekte harduerike. Avancim kemi bërë sistemin e raportimit, në katër module të sistemeve aktuale, dhe një në server room (harduer). Ndërsa menaxhimi, administrimi dhe mirëmbajtja është realizuar për sistemet teknologjike aktuale, të reja dhe të vjetrat.




Figura 1. Paraqitja grafike e projekteve dhe aktiviteteve kryesore të teknologjisë informative

### Transformimi digjital ndër vite

Agjencia ka bërë transformim rrënjësor digjital në proceset e punës së saj. Tani pothuajse të gjitha proceset kryesore të punës së saj i realizon në trajtë elektronike, duke filluar nga listat e subjekteve deklaruese, deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publik, verifikimin dhe kontrollin e plotë të pasurisë, raportimin elektronik të rasteve dhe trajtimin e tyre deri në finalizim si në konflikt të interesit, sinjalizim, deklarim të pasurisë dhe dhuratave, plane të integritetit, monitorim dhe vlerësim të rrezikut për korrupsion në sektor të caktuar, etj. Ky transformim digjital ka marrë hov të madh në katër vitet e fundit, ku digjitalizimin e plotë të punës dhe aplikimin e inteligjencës artificiale, Agjencia e ka pjesë të strategjisë së saj për zhvillim.

Në figurën në vijim është paraqitur në mënyrë grafike zhvillimi teknologjik në Agjenci si pjesë e transformimit digjital ndër vite, ku raporti i moduleve që ofrojnë shërbime digjitale të Agjencisë në vitin 2025 ka qenë 13 krahasuar me vitin 2022 që ishte vetëm një. Kjo do të thotë se në aspektin e ofrimit të shërbimeve elektronike nga vitin 2022 në vitin 2025, është rrit numri i moduleve digjitale për 1200%, ndera krahasuar me vitin 2024 është rritë për 85.70%. Kjo rritje ka përshpejtuar verifikimin e rasteve, rritur transparencën dhe zvogëluar kohën operative të sektorëve të Agjencisë.




Figura 2. Raporti i transformimit digjital të Agjencisë për periudhën 2022 – 2025

Rrjedhimisht, gjatë vitit 2025, Agjencia ka arritur një nivel të ri të transformimit digjital, duke krijuar një ekosistem të qëndrueshëm elektronik të proceseve të saj të punës. Sistemet e reja, infrastrukturat e avancuara, integrimet ndër-institucionale dhe rritja e numrit të shërbimeve elektronike e pozicionojnë Agjencinë si një institucion modern, efikas dhe të orientuar drejt inovacionit dhe inteligjencës artificiale. Këto zhvillime përbëjnë bazën strategjike për projektet e viteve në vijim.

### TRAJTIMI I RASTEVE TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Edhe gjatë vitit 2025, parandalimi dhe menaxhimi i situatave të konfliktit të interesit ka qenë një nga komponentat, në të cilën Agjencia i ka kushtuar rëndësi të veçantë mënyrës dhe procedurës së trajtimit dhe menaxhimit të rasteve. Në këtë drejtim, Agjencia ka vazhduar me detyrat dhe përgjegjësitë e saj dhe ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e situatave të konfliktit të interesit, sipas Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Gjatë periudhës raportuese janar - dhjetor 2025, në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit të raportuara, dyshuara apo pretenduara, janë paraqitur gjithsej 174 raste.

Krahasuar me vitet paraprake, përkatësisht në tre vitet e fundit, në vitin 2023 kanë qenë 214 raste, në vitin 2024 kanë qenë 220 raste, ndërsa në vitin 2025 janë gjithsej 174 raste.




Figura 3. Paraqitja grafike e rasteve të trajtuara për konflikt të interesit për periudhën 2023-2025

## DEKLARIMI I PASURISË

Deklarimi i pasurisë është një mekanizëm mjaft i rëndësishëm i cili ndikon në rritjen e transparencës dhe luftimit të korrupsionit në sektorin publik. Procesi i deklarimit të pasurisë edhe gjatë vitit 2025 u karakterizua me rritjen e përgjegjësisë të zyrtarëve të lartë publikë për ta kryer këtë obligim ligjor brenda afateve ligjore.

Në vitin 2023, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-108, numri i subjekteve deklaruese është dyfishuar dhe është përcaktuar që deklarimi të bëhet vetëm në mënyrë elektronike, duke siguruar një proces më të shpejtë, më të saktë dhe më të sigurt.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara për 3 vitet e fundit, në vitin 2023, 99.60% e subjekteve e kanë përmbushur detyrimin ligjor për deklarimin e pasurisë, duke reflektuar një rritje të ndjeshme të ndërgjegjësimit dhe angazhimit. Në vitin 2024, duke i marrë parasysh edhe dy kategoritë e reja të përfshira, në kuadër të obligimit ligjor për deklarim të pasurisë si mjekët dhe profesorët, nga 11168 subjekte deklaruese gjithsej, 11070 ose (99.12%) kanë respektuar afatin ligjor, ndërsa 98 ose (0.88%) nuk e kanë respektuar afatin ligjor.

Ndërsa në vitin 2025 duke ju referuar të dhënave të raportuara nga 12682 subjekte deklaruarës, 12488 ose (98.47%) kanë respektuar afatin ligjor, ndërsa 194 ose (1.56%) nuk e kanë respektuar afatin ligjor.




Figura 4. Paraqitja grafike e deklaramit të pasurisë për periudhën 2023-2025

## TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT

Mbikëqyrja e procesit të sinjalizimit dhe marrja e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve, si një nga përgjegjësitë kryesore të Agjencisë, është realizuar sipas legjislacionit në fuqi Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve si dhe Rregulloren Nr 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit.

Agjencia përmes këtij raporti pasqyron një punë të detajuar për një vit lidhur me rastet e sinjalizimit në institucionet publike, subjektet private si dhe rastet e trajtimit të sinjalizimit të jashtëm nga vetë Agjencia, përfshirë aktivitete të shumta të ndërmarra në kuadër të procesit, numrin e rasteve të trajtuara si dhe veprimet e ndërmarrë për ato raste.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka pranuar dhe evidentuar gjithsej 92 raportime/sinjalizim i jashtëm. Nga 20 raste të pranuar në vitin 2023, në vitin 2024 numri i rasteve ka arritur në 48, ndërsa gjatë vitit 2025, ka arritur në 92 raste, pra kjo tregon se numri i rasteve në vitin 2025, është rritur me rreth 91.7% krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje mund të interpretohet si një shenjë pozitive për kulturën e sinjalizimit dhe besimin që qytetarët kanë për të raportuar aktivitete të dyshimta ose të paligjshme, duke u mbështetur në mbrojtjen që ofron Ligji për Sinjalizuesit.




Figura 5. Paraqitja grafike e rasteve të trajtuara të sinjalizimit për periudhën 2023-2025

## ZBATIMI I LEGJISLACIONIT KUNDËR KORRUPSIONIT, SI DHE PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I TIJ

Gjatë vitit 2025 Agjencia ka vazhduar misionin e saj drejtë zbatimit të legjislacionit si dhe përmirësimin e tij, përmes miratimit të akteve nënligjore si dhe dokumenteve të rëndësishme strategjike si: rregullore, metodologji, udhëzues praktik, duke i përmbush kështu detyrimet e saj në aspekt të plotësisimit dhe zbatimit të plotë të legjislacionit në fuqi. Veprimtaria e Agjencisë mbështetet në ligjet si në vijim:

- Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave;
- Ligji Nr. 06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik; si dhe
- Ligji Nr. 06/L-085 Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve;

Në kuadër të kësaj, Agjencia ka vazhduar plotësimin e kornizës ligjore, miratimin e akteve nënligjore dhe dokumenteve strategjike si në vazhdim:

- Rregullorja Nr. 01/2025 për Procedurën e Verifikimit dhe Kontrollit të Deklarimit të Pasurisë nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit;
- Rregullorja Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Rregullorja Nr. 04/2025 për Pranimin dhe Regjistrimin e Dhuratave nga Personat Zyrtarë.
- Udhëzim Administrativ Nr. 02/2025 për Përdorimin, Shfrytëzimin dhe Menaxhimin e Automjeteve në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

- Udhëzim Administrativ Nr. 03/2025 për Shfrytëzimin e telefonisë ( fikse, VoIP dhe mobile ) në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Varësisht nevojave dhe kërkesave të ndryshme ligjore, janë përpiluar parashtresa të shumta juridike (vendime, kërkesa, përgjigje, kontrata, memorandume mirëkuptimi), si dhe janë ofruar po ashtu, përgjigje, opinione apo këshilla të ndryshme profesionale për të gjitha njësitë organizative brenda institucionit, në analizimin e çështjeve të ndryshme brenda mandatit të institucionit dhe aktivitete të tjera që hyjnë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të Agjencisë.

## **RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA NË AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT (PROKURORI DHE GJYKATA)**

Gjatë periudhës raportuese në institucionet kompetente të drejtësisë si: Prokurori të Shtetit/Zyre të kryeprokurorit të Shtetit si dhe Gjykata, Agjencia ka përcjellë për procedim të mëtutjeshëm gjithsej 19 kallëzime penale dhe 78 informata në prokurori, ndërsa 11 raste tjera në Gjykatën për Kundërvajtje.

Gjatë periudhës raportuese, gjithsej 43 kallëzime penale të paraqitura nga Agjencia janë refuzuar nga prokuroritë, ku pjesa më e madhe e këtyre vendimeve është mbështetur në interpretimin juridik të dhënë në Aktgjykimin Pml. Nr. 73/2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në mënyrë më specifike, gjatë vitit 2025 Agjencia ka pranuar një numër të konsiderueshëm aktvendimesh për pushimin e hetimeve nga prokuroritë themelore, të cilat në mënyrë taksative janë mbështetur në këtë aktgjykim të Gjykatës Supreme. Po ashtu, në disa raste të tjera që ndërlidhen me kallëzime penale të paraqitura nga Agjencia, hetimet janë pushuar duke u bazuar në interpretimin juridik të dhënë nga Gjykata Supreme, megjithëse pa iu referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë këtij aktgjykimi.

Thelbi i këtij interpretimi juridik mbështetet në zbatimin dhe leximin e dispozitave të një ligji që është shfuqizuar në vitin 2014, gjë që në praktikë ka prodhuar efektin e dekriminalizimit të veprave penale që lidhen me mosdeklarimin, deklarimin e rrejshëm apo deklarimin e pasaktë të pasurisë dhe dhuratave.

Një qasje e tillë jo vetëm që ka krijuar pasiguri juridike, por njëkohësisht ka rrezikuar realizimin e misionit ligjor të Agjencisë në fushën e deklarimit të pasurisë dhe dhuratave, duke dobësuar funksionin parandalues dhe ndëshkues të normave përkatëse.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë pranuar edhe tre (3) aktgjykime të gjykatave, të cilat kanë ndjekur të njëjtën bazë arsyetimi juridik si ajo e përcaktuar në aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, duke konsoliduar në praktikë një standard interpretativ me pasoja të drejtpërdrejta në trajtimin penal të këtyre veprave.

## INFORMATA STATISTIKORE PËR VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA

Nga informacionet e pranuar gjatë vitit 2025, nga Gjykatat respektive lidhur me rastet e dyshuara për korrupsion sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë kompetente mbi bazën e kallëzimeve penale të Agjencisë, janë nxjerr 3 Aktgjykime dënuese dhe 4 aktgjykime liruese.

Nr.	Gjykata	Aktgjykim dënues	Aktgjykim lirues	Aktvendime
1	GJTH. Prishtinë	1	2	0
2	GJTH. Prizren	0	-	-
3	GJTH. Gjilan	0	-	-
4	GJTH. Gjakovë	0	2	-
5	GJTH. Mitrovicë	2	0	-
<b>GJITHSEJ</b>		<b>03</b>	<b>4</b>	<b>0</b>

Tabela Nr.3 pasqyron të dhënat nga vendimet e gjykatave përkitazi me Nenin 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës

Me aktgjykime dënuese Gjykatat kanë shqiptuar kryesisht dënime me gjobë, ka raste kur janë shqiptuar edhe dënime me kusht (dënime me gjobë dhe burgim).

Dënimet me gjobë janë shqiptuar në shumë prej 250 euro. Këto dënime është caktuar që të paguhet kryesisht pas plotfuqishmërisë së aktgjykimeve, me mundësinë e revokimit në dënim me burg, ku 20 euro do të llogaritet me një ditë burgimi në rast se i akuzuari nuk e paguan atë dhe e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim.

Dënimet me kusht kryesisht janë shqiptuar me dënime me burgim nga 3 deri në 6 muaj.

Aktgjykimet dënuese i referohen veprës penale nga neni 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës, ka gjithsej 3 raste të dënimit prej tyre 2 raste për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkatësisht janë për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë dhe 1 rast për deklarim të rremë të pasurisë apo mos paraqitje të të dhënave të kërkuara në deklaratë sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Me aktgjykim lirues, ka gjithsej 4 raste. Në 3 raste Gjykata ka liruar nga akuza të akuzuarit për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 1, dhe një rast për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 2.

Ka pasur vetëm 1 Aktgjykim nga gjykata kompetente dënim me gjobë në lidhje me Konfliktin e Interesit.

### PËRFAQËSIMI I RASTEVE NË GJYKATA

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka përfaqësuar gjithsej në 19 raste të iniciuara në institucionet e drejtësisë, prej të cilave 11 raste kanë qenë të natyrës penale, ndërsa 8 prej këtyre rasteve kanë qenë të natyrës juridiko-civile. Në një rast Agjencia ka përfaqësuar në Prokurori Speciale. Çështjet penale për të cilat Agjencia ka

përfaqësuar në Gjykata dhe Prokurori kanë qenë për vepër penale: “Mos deklarimi ose deklarimit i rrejshëm i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave ose i dobisë tjetër materiale” sipas Kodit Penal të Kosovës.

Përfaqësimi i Agjencisë në Gjykata dhe Prokuroritë kompetente, është bërë në faza të ndryshme varësisht se në cilën fazë kanë qenë duke u zhvilluar procedurat për rastet konkrete.

## PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

Një nga shtyllat themelore të funksionimit dhe përmbushjes së mandatit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, është parandalimi i konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë vitit 2025, Agjencia ka vazhduar të ushrojë kompetencat dhe përgjegjësitë sipas ligjit, duke ndërmarrë veprime hetimore administrative për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit. Varësisht natyrës së rasteve të trajtuara, Agjencia ka ofruar këshilla dhe përgjigje zyrtare, si dhe ka nxjerrë rekomandime, opinione dhe vendime konkrete, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Kontribut të veçantë në përmbushjen në parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike, kanë dhënë edhe Autoritetet përgjegjëse nëpër institucionet publike të vendit. Në funksion të këtij qëllimi, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes mekanizmave të saj të brendshëm, vazhdimisht ka ofruar mbështetje profesionale për institucionet/autoritetet përgjegjëse, duke i përgatitur dhe zhvilluar ato sa më mirë, në mënyrë që qysh në burim të bëhet identifikimi, trajtimi dhe zgjidhja e rasteve të konfliktit të interesit, brenda institucioneve të tyre.

Veprimet e Agjencisë në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, janë ndërmarrë në mënyrë objektive, të paanshme dhe profesionale, krejt këto duke qenë gjithnjë në zbatim të legjislacionit relevant në fuqi. Kjo zakonisht bëhet përmes inicimit të rasteve sipas detyrës zyrtare, informacioneve të pranuar nga personat fizik apo juridik, informatat e pranuar në formë anonime si dhe informatave nga publiku. Këto veprime bëhen në zbatim të ligjit në radhë të parë, por edhe me qëllim të forcimit të integritetit dhe transparencës institucionale në Republikën e Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese janar - dhjetor 2025, në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit të raportuara, dyshuara apo pretenduara, janë paraqitur gjithsej 174 raste.

Përveç 174 rasteve të trajtuara, Agjencia përmes adresës së saj zyrtare elektronike ka ofruar gjithashtu një numër të konsiderueshëm të përgjigjeve për çështje të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërive të cilat janë adresuar nga zyrtarë dhe institucione të ndryshme. Gjatë vitit 2025 janë dhënë gjithsej 116 përgjigje për palët përmes adresës zyrtare të Agjencisë ([info.apk@rks-gov.net](mailto:info.apk@rks-gov.net)) lidhur me pyetjet dhe kërkesat e parashtruara.

Krahasuar me vitet paraprake, përkatësisht me tre vitet e fundit, në periudhën raportuese janar - dhjetor, Agjencia ka vazhduar me një dinamikë afërsisht të njëjtë, sa i takon numrit të trajtimit të rasteve për parandalimin e konfliktit të interesit, e sidomos në aspektin e dhënies së përgjigjeve për situata të caktuara që lidhen me dyshime për papajtueshmëri ose ushtrim të funksionit në kushte të konfliktit të interesit.

Epilogu i rasteve të trajtuara nga Agjencia për periudhën raportuese është si në vijim: 73 raste janë dhënë përgjigje dhe opinione, janë nxjerrë 63 vendime për rastet. Në 8 prej tyre, subjektet e trajtuara nga Agjencia, e kanë shmang konfliktin e interesit, ndërsa 46 raste prej tyre kanë rezultuar pa konflikt të

interesit. Dy raste tjera janë përcjellë për procedurë të mëtutjeshme në Prokurorinë e Shtetit, 7 raste janë përcjellë në Gjykatën kompetente për kundërvajtje, si dhe 38 raste janë bartur në vitin vijues.

Vlen të theksohet se përveç raportimeve dhe kërkesave të sipërpërmendura për trajtimin e pretendimeve për konflikt të interesit, në Agjenci janë adresuar 5 raste për vlerësim përfundimtar të konfliktit të interesit edhe nga institucione ligj-zbatuese, si Prokuroria e shtetit dhe Policia e Kosovës.

Institucioni	Rastet e trajtuara	Rastet e shmangies nga K.I.	Rastet pa konflikt interesi	Rastet në Gjykatë	Rastet në Prokurori	Opinione Përgjigje	Rastet në Procedurë
Kuvendi i Kosovës	1	0	0	0	0	1	0
Qeveria (Min. Agje. Uni.)	92	3	22	3	1	42	22
Gjykatat	2	1	0	0	0	0	1
Prokuroritë	4	0	0	0	0	4	0
Institucionet e Pavarura	28	1	4	1	0	13	7
Ndërmarrjet Publike	16	2	4	0	0	6	3
Pushteti Lokal	31	1	16	3	1	7	5
<b>Gjithsej</b>	<b>174</b>	<b>8</b>	<b>46</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>73</b>	<b>38</b>

*Tabela Nr.4 pasqyron rastet e trajtuara nga Agjencia gjatë vitit 2025*

Sipas Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit (Nr. 06/L-011), përkatësisht nenit 20 të tij, nga aspekti i obligimeve për trajtimin e konfliktit të interesit nga autoritetet përgjegjëse të institucioneve publike, që përfshijnë udhëheqësit e drejtpërdrejtë të zyrtarëve sipas hierarkisë dhe autoritetet e caktuara brenda institucioneve, viti 2025 për shumicën e institucioneve u karakterizua me trend afërsisht të njëjtë të numrit të rasteve të trajtuara, me një përjashtim të theksuar për nga numri i rasteve të trajtuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Institucioni	Rastet e paraqitura në AP	Rastet e shmangies nga K.I.	Rastet pa konflikt interesi	Rastet me konflikt interesi/ procedurë disiplinore	Opinione Përgjigje	Rastet në Procedurë	Raste të dërguara në APK
Presidenca	1	0	0	0	0	0	1
Kuvendi i Kosovës	0	0	0	0	0	0	0
Qeveria (Min. Agjenc. Uni.)	112	41	8	3	40	2	18

<b>Gjykatat</b>	625	497	125	2	0	0	1
<b>Prokuroritë</b>	0	0	0	0	0	0	0
<b>Institucionet e Pavarura</b>	43	29	3	2	9	0	0
<b>Ndërmarrjet Publike</b>	9	3	1	1	2	0	2
<b>Pushteti Lokal</b>	17	12	0	1	0	0	4
<b>Gjithsej</b>	<b>807</b>	<b>582</b>	<b>137</b>	<b>9</b>	<b>51</b>	<b>2</b>	<b>26</b>

*Tabela Nr .5 pasqyron specifikat e rastet e trajtuara nga Autoritetet Përgjegjëse gjatë vitit 2025*

Sa u takon raportimeve të Autoriteteve përgjegjëse, nga 172 institucione që kanë raportuar, janë gjithsej 807 raste qe janë identifikuar dhe trajtuar ne 49 institucione publike.

Në kuptim të kësaj, krahasuar me tri vitet e fundit ekziston një tendencë e ngritjes nga viti në vit e numrit të rasteve të trajtuara nga autoritetet përgjegjëse, dhe atë si në vijim: në vitin 2023 janë trajtuar 181 raste, në vitin 2024 janë trajtuar gjithsej 185 raste nga autoritetet përgjegjëse, kurse për vitin që po raportojmë AP-të janë trajtuar 807.

### **Aktivitetet në funksion të forcimit dhe fuqizimit të autoriteteve përgjegjëse**

Me qëllim të vetëdijesimit sa më të hershëm me obligimet, masat dhe mënyrat për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe në funksion të rritjes së bashkëpunimit ndër-institucional, gjatë vitit 2025 Agjencia ka realizuar disa trajnime të rëndësishme në institucione publike të vendit. Vlen të theksohet këtu trajnimi për gjithë stafin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), përfshirë edhe menaxhmentin e tyre të lartë, që është bërë me kërkesë të vet ZKA-së.

Ky trajnim është mbajtur në katër ditë pune në kuadër të trajnimeve të rregullta që kanë në ZKA, e në to është inkorporuar edhe tema "Obligimi për Parandalimin e konfliktit të interesit, kuadri ligjor dhe procedurat".

Po ashtu, duhet theksuar edhe trajnimin me dy grupe të autoriteteve të përzgjedhura përgjegjëse që është mbajtur në Pejë, me temën "Rëndësia e Parandalimit të konfliktit të interesit në burim".

Këto trajnime janë vlerësuar lartë nga të gjithë pjesëmarrësit, dhe si rezultat Agjencia ka marrë inpute të rëndësishme për orientimin dhe përmirësimin e strategjive parandaluese të Agjencisë për vitet e ardhshme.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka realizuar poashtu edhe vizita në institucione të ndryshme publike të vendit, në kuadër të të cilave janë zhvilluar takime me autoritetet përgjegjëse të emëruara për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit në ato institucione, e herë herë edhe me drejtuesit e tyre, përfshirë këtu edhe fushatat vetdijësuese në shkolla dhe fakultete.

Në këto takime, zyrtarë të Agjencisë janë njoftuar për sfidat dhe përpjekjet që po ndërmarrin institucionet si: ZKA, UP, QKUK, KEK etj, për të identifikuar dhe adresuar sa me herët rastet e konfliktit të interesit nëpër institucionet e tyre përkatëse. Ndërsa kanë mbetë akoma si kërkesa të hapura, për tu realizuar gjatë këtij

viti me: Zyrën e Thesarit, Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës etj.



Poashtu, vlen të theksohet aktiviteti gjithëditor i organizuar në kuadër të “Javës kundër Korrupsionit” me panelistët dhe pjesëmarrësit (autoritetet përgjegjëse të institucioneve) lidhur me temën e diskutimit “Parandalimi i konfliktit të interesit në arsimin e lartë”.

## ANALIZA:

Edhe më tutje, d.m.th. edhe këtë vit, numri i kërkesave për trajtimin e konfliktit të interesit, përkatësisht papajtueshmërive në ushtrimin e funksioneve publike vazhdon të jetë i madh. Kjo për faktin se edhe gjatë vitit raportues ka pas lëvizje me zgjedhje dhe emërimë në pozita drejtuese në institucionet dhe ndërmarrjet publike të vendit, por nga ana tjetër edhe për faktin se Agjencia tashmë shihet e kuptohet edhe nga jashtë, si adresa me besueshmëri të lartë dhe profesionale për vlerësimin dhe trajtimin e situatave të dyshuara për konflikt interesi dhe papajtueshmëri.

Pra, numri i madh i kërkesave për trajtimin e situatave të dyshuara për papajtueshmëri dhe konflikt interesi, tregon besimin në ngritje të vazhdueshme dhe gatishmërinë e zyrtarëve publik dhe qytetarëve për të adresuar këto çështje në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si institucion i specializuar për trajtimin e këtyre problematikave.

Ajo që duhet theksuar për këtë vit, e që është inkurajuese, sepse tregon për zbatim të mirë të masave për parandalimin e konfliktit të interesit qysh në burim, është fakti se p.sh. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i janë deklaruar dhe ka evidentuar numër të lartë të situatave të konfliktit të interesit që pastaj janë shqyrtuar në nivelin e KGJK-së.

Ky është shembulli më i mirë se si në fakt do të duhej të zbatohet Ligji për PKI dhe se si do të duhej të parandalohej konflikti i interesit qysh në burim.

Megjithatë, ky shembull i mirë nuk është se ka qenë kështu në të gjitha institucionet publike. Përkundër aktiviteteve të ndryshme vetëdijësuese të organizuara gjatë vitit nga Agjencia, këshillimeve të vazhdueshme, si dhe trajnimeve në kontinuitet, për obligimet, mënyrën e trajtimit dhe procedurat për autoritetet përgjegjëse, akoma nëpër institucione publike vërehet një hezitim, që zyrtarët publik apo udhëheqësit e tyre të drejtpërdrejtë, të kërkojnë dhe tu besojnë atyre trajtimin fillestar, mbase edhe të

përbashkët, ashtu siç e kanë obligim ligjor. Shumë autoritete përgjegjëse të institucioneve anashkalohen, ose nuk aktivizohen fare për të zgjidhur rastet e konfliktit të interesit brenda institucioneve të tyre, dhe çdo kërkesë apo situatë që kanë zyrtarët e institucioneve të ndryshme, pa ngurrim e drejtojnë direkt në Agjenci, e në fakt Agjencia do të duhej të përfshihej vetëm në raste të veçanta apo specifike ku është e domosdoshme përfshirja e saj.

Gjithashtu duhet theksuar se në këtë vit raportues, 5 kërkesa në Agjenci janë përcjellë përmes Policisë së Kosovës, për trajtim të konfliktit të interesit për rastet që janë raportuar dhe iniciuar direkt nga Prokuroritë e ndryshme apo edhe nga vet Policia e Kosovës.

Lidhur me natyrën dhe karakteristikat e vendimeve që Agjencia i ka nxjerrë gjatë vitit 2025, ka pas vendime të natyrave të ndryshme, por gjithnjë me qëllim të shmangies së vendimmarrjeve me konflikt interesi, apo papajtueshmërive në ushtrimin e funksioneve publike.

P.sh.:

Në vijim një pasqyrë e përmbledhur e veprimeve të dhe ndaj zyrtareve të lartë publik për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksioneve publike:

- **Shtatë (7)** kërkesa në gjykatat kompetente, për fillim të procedurës kundërvajtëse për zyrtarët e lartë;
- **Pesë (5)** dorëheqje nga funksionet drejtuese në Organizata Jo Qeveritare;
- **Katër (4)** dorëheqje nga funksioni menaxhuese/drejtues dhe/ose person i autorizuar në biznese private;
- **Tri (3)** dorëheqje nga një funksion publik për shkak të papajtueshmërisë me një funksion tjetër publik;
- **Tri (3)** procedura disiplinore në institucione përkatëse për zyrtarët publik për shkak të K.I.;
- **Dy (2)** raste kundërvajtëse për zyrtarë të lartë me shkelje të kufizime pas largimit nga funksioni publik.
- **Dy (2)** raste janë iniciuar me kallëzim penal në Prokurorinë kompetente;
- **Një (1)** Vendim të Gjykatës për dënim me gjobë për zyrtarin e lartë publik, për shkak të vendimmarrjes në kushte të konfliktit të interesit.

## DEKLARIMI SIPAS LLOJEVE

Bazuar në obligimet ligjore të përcaktuara me Ligjin nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Agjencia ka vazhduar ta mbikëqyrë procesin e deklarimit të pasurisë së subjekteve deklaruese, lidhur me pasurinë e deklaruar përmes Deklarimit të rregullt vjetor, Deklarimit me marrjen e detyrës dhe Deklarimit pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni.

Deklarimi i rregullt vjetor - Zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarin e rregullt vjetor të pasurisë për çdo vit gjatë tërë kohës së punës në shërbimin publik, sipas afateve të përcaktuara me ligj dhe janë të obliguar ta deklarojnë gjendjen e pasurive të tyre në APK, nga 1 deri më 31 mars të çdo viti për vitin paraprak nga 1 janar deri më 31 dhjetor. Deklarimin e rregullt vjetor për vitin 2025 kanë qenë të obliguar ta bëjnë gjithsej 10485 subjekte deklaruese.

Nga numri i përgjithshëm e kanë deklaruar pasurinë 10344, prej tyre 141 subjekte deklaruese nuk e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit.

*Lista e Deklarimit të rregullt vjetor sipas Institucioneve*

Institucionet	Zyrtarët e obliguar ta deklarojnë pasurinë	Kanë deklaruar	Nuk kanë deklaruar
Presidenca	23	22	1
Kuvendi	147	147	1
Qeveria	3299	3181	118
Gjykatat	570	567	3
Prokuroritë	232	1	1
Institucionet e Pavarura	607	607	0
Komunat e Kosovës	1196	1184	12
Ndërmarrjet Publike	524	519	5
<b>TOTALI</b>	<b>10485</b>	<b>10344</b>	<b>141</b>

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2025, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarin të rregullt vjetor të pasurisë paraqitet përmes tabelës në vijim përfshirë krahasimet me vitin 2023 dhe vitin 2024.

Vitet	Të obliguar për deklarin	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2023	4709	4698 (99.77%)	11 (0.23%)
2024	7906	7816 (98.86%)	90 (1.14%)
2025	10485	10344(98.66%)	141(1.34%)

*Tabela Nr.6 krahasimet për vitet 2023-2025 lidhur me procesin e deklarin të rregullt vjetor të pasurisë*

**Deklarimi me marrjen e detyrës** - Zyrtarët e lartë publik të cilët fillojnë punën në shërbimin publik në mënyrë të plotë dhe reale deklarojnë pasurinë e tyre brenda afatit ligjor në periudhën prej 30 ditësh nga dita e marrjes së detyrës.

Gjatë vitit raportues, Agjencia ka pranuar informacione nga zyrtarët kontaktues për zyrtarët publikë që kanë marrë detyrën gjatë kësaj periudhe dhe të cilët, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë qenë të obliguar të deklarojnë pasurinë.

Të obliguar për deklarimin e pasurisë me marrje të detyrës, kanë qenë **1202** subjekte deklaruese, **1180** prej tyre kanë deklaruar pasurinë brenda afatit kohor, ndërsa **22** nuk e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2025, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të pasurisë deklarimit me marrjen e detyrës, paraqitet në tabelën në vijim, përfshirë krahasimet me vitin 2023 dhe vitin 2024.

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2023	4377	4350 (99.38%)	27(0.62%)
2024	3161	3153 (99.74%)	8 (0.26%)
2025	1202	<b>1180 (98.16%)</b>	<b>22 (1.84%)</b>

*Tabela Nr.7 krahasimet për vitet 2023-2025 lidhur me procesin e deklarimit me marrje të detyrës*

**Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni** – Me rastin e përfundimit të angazhimit në pozitën publike, zyrtarët publik janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë brenda afatit prej 30 ditëve.

Gjatë vitit raportues Agjencia ka pranuar informacione nga zyrtarët kontaktues se ushtrimin e funksionit publik e kanë përfunduar **995** subjekte deklaruese, të cilët kanë qenë të obliguar të deklarojnë pasurinë pas largimit nga funksioni publik, ku **2** prej tyre e kanë deklaruar me vonesë.

Ndërsa, sa i përket të dhënave krahasuese lidhur me procesin e deklarimit të pasurisë pas mbarimit të funksionit publik për 3 vitet e fundit 2023, 2024 dhe 2025, paraqiten në tabelën në vijim:

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar brenda afatit	Nuk kanë deklaruar brenda afatit
2023	545	545 (100%)	0 (0 %)
2024	101	101(100%)	0 (0 %)
2025	995	993(99.8)	2 (0.20%)

*Tabela Nr.8 krahasimet për vitet 2023-2025 lidhur me procesin e deklarimit pas mbarimit të funksionit publik*

Bazuar në të dhënat e raportuara gjatë vitit 2025, për të gjitha llojet e deklarimit të pasurisë, kanë qenë të obliguar ta bëjnë deklarimin 12682 zyrtar të lartë publik, sikurse në tabelën në vijim:

Lloji i deklarimit	Të obliguar
Deklarimi i rregullt vjetor	10485
Me marrjen e detyrës	1202
Pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni	995
Numri i përgjithshëm	12682

*Tabela Nr.9 pasqyron të dhënat lidhur me obligimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë sipas llojeve të deklarimit*

Sipas Ligjit nr. 08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjit nr. 08/L-108, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Rregullores nr.06/2024 për Shqiptimin e Gjobave si dhe Masave Tjera Sanksionuese nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe në kuptim të zbatimit të dispozitave të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

**Për deklarim të rregullt vjetor** gjatë vitit 2025 Agjencia ka shqiptuar gjoba ndaj 115 subjekteve deklaruese në shumën totale prej 32426.27 Euro, ndërsa në 20 raste ka shqiptuar masë “qortim jo publik” për subjekte deklaruese dhe zyrtarë kontaktues, si dhe në 6 raste ka pushuar procedurën ndaj subjekteve deklaruese për shkak se kanë ndërruar jetë, ose për arsye të tjera.

**Për deklarim me marrje detyre dhe me mbarim të funksionit** gjatë vitit 2025 Agjencia ka shqiptuar gjoba ndaj 14 subjekteve deklaruese në shumën totale prej 4563.70 Euro, ndërsa në 17 raste ka shqiptuar masë “qortim jo publik” për subjekte deklaruese dhe zyrtarë kontaktues.

Me tutje Agjencia gjatë muajit dhjetor ka vazhduar verifikimin e listat për deklarim me marrje detyre dhe me mbarim të funksionit gjatë vitit 2025 dhe pas verifikimit ka konstatuar se rreth 55 subjekte deklaruese janë vonuar në proces të deklarimit.

Po ashtu Agjencia, gjatë vitit 2025 ka dorëzuar 16 kallëzime penale për subjekte deklaruese të cilët e kanë deklaruar pasurinë me vonesë apo nuk e kanë deklaruar fare.

Numri i masave ndëshkuese	
Kallëzime Penale	16
Gjoha	129
Qortime Publike	
Qortime Jo publike	37
Raste vdekje dhe të tjera	6 Numri i Ankesave gjatë vitit 2025

*Tabela Nr.10 pasqyron të dhënat lidhur me masat ndëshkuese*

*Aktualisht jemi në proces të verifikimit të listave të deklarimit me marrje detyre dhe me përfundim të funksionit për periudhën 20.11.2025-31.12.2025, subjekte deklaruese të cilët kanë pasë vonesa në deklarim të pasurisë apo nuk e kanë deklaruar fare.*

## Raport mbi trajtimin e ankesave për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, Komisioni i Ankesave të Agjencisë ka pranuar gjithsejtë 57 ankesa nga subjektet deklaruese dhe zyrtarët kontaktues, lidhur me vendimet e Agjencisë për shqiptimin e masave ndëshkimore. Pas shqyrtimit të detajuar nga Komisioni i Ankesave:

- 41 ankesa janë refuzuar;
- 4 ankesa janë aprovuar pjesërisht;
- 9 ankesa janë aprovuar me udhëzimin për tu kthyer në rivlerësim të vendimit nga njësia përgjegjëse për propozimin e shqiptimit të gjobave të Agjencisë;
- 3 ankesa janë aprovuar plotësisht;

Numri i Ankesave gjatë vitit 2025				
Refuzuar	Aprovuar plotësisht	Aprovuar pjesërisht	Në rivlerësim	Gjithsej ankesa
41	3	4	9	57

Tabela Nr.11 pasqyron numrin e ankesave të trajtuar nga Komisioni i Ankesave i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

## KONTROLLI I PLOTË 2025

### RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA NË PROKURORI TË SHTETIT

Gjatë procedurës së zhvilluar hetimore në kuadër të kontrollit të plotë së pasurisë së subjekteve deklaruese, për periudhën raportuese Agjencia ka përcjellë 17 kallëzime penale dhe 61 informata në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, për shqyrtim dhe trajtim të mëtutjeshëm.

Këto kallëzime penale dhe informata kanë të bëjnë me veprime të sanksionuara sipas nenit 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës “ Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”.

### INFORMATA STATISTIKORE PËR VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA

Nga informacionet e pranuar gjatë vitit 2025, nga Prokuroria e Shtetit lidhur me rastet e dyshuara për korrupsion sipas dyshimeve të pretenduara nga Agjencia, janë nxjerr 43 Aktvendime refuzuese (hedhje të aktakuzave apo pushimin e hetimeve).

## KONTROLLI I PASURISË

Sipas Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Agjencia ka zhvilluar kontrollin e plotë të formularëve për deklarim të pasurisë të paraqitur nga subjektet deklaruese. Agjencia ka qenë e përkushtuar gjatë gjithë kohës për trajtimin e rasteve brenda afateve kohore, mirëpo duke pasur parasysh çështjet teknike të zhvillimit të kontrollit përmes sistemit elektronik

DMSA-CMS është filluar me vonesë procesi i grumbullimit të informacioneve nga institucionet relevante lidhur me verifikimin e deklaramëve të pasurisë së deklaruar në Agjenci nga subjektet deklaruese. Në vitin 2024 të gjitha rastet e kontrollit të plotë prej 1321 raste janë bartur në vitin 2025 për shkak të mungesës së stafit dhe punëve të shumta gjatë vitit, dhe si rezultat kontrolli ka filluar me vonesë. Në vitin 2025 janë bartur për vitin 2026, 253 raste sipas listës së kontrollit, si dhe 7 raste nga informacionet e pranuar në fund të vitit kalendarik. Gjatë vitit 2025 ka filluar kontrolli i plotë për 1504 subjekte deklaruese, sipas nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-108 për kategoritë e përcaktuara me nenin 4 dhe 5 të ligjit. Po ashtu, për 20 subjekte tjera deklaruese ka filluar kontrollit i plotë sipas informacioneve të pranuar lidhur me dyshimet për deklaram të pa saktë të pasurisë.

### Bartja e rasteve për kontroll të pasurisë ndër vite

Të dhënat tregojnë një trend në rënie të numrit të rasteve të bartura nga vitet paraprake, ku nga viti 2023 në vitin 2024 janë bartur 1716 raste, nga viti 2024 në vitin 2025 janë bartur 1321 raste, ndërsa nga viti 2025 në vitin 2026 janë evidentuar 260 raste të bartura. Kjo rënie vlerësohet të jetë rezultat i rritjes së efikasitetit në punë, përmirësimit të procedurave të brendshme dhe avancimit të proceseve të digjitalizimit në trajtimin e rasteve.

Bartja e rasteve për kontroll të pasurisë ndër vite	
Rastet e bartura nga viti 2023 në vitin 2024	1716
Rastet e bartura nga viti 2024 në vitin 2025	1321
Rastet e bartura nga viti 2025 në vitin 2026	260

Tabela Nr.12 --- pasqyron të dhënat e bartjes së rasteve nga kontrolli i plotë 2024-2026

**Kontrolli i plotë** - Bazuar në obligimet ligjore, Agjencia ka zhvilluar procesin e kontrollit të plotë të pasurisë për ta verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të deklaruara në formularët e deklaramit të pasurisë për subjektet deklaruese të cilët deklarojnë pasurinë.

Kontrolli i pasurisë për subjektet deklaruese është bërë sipas kategorizimit të përcaktuar me Ligjin nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave. Të gjitha subjektet deklaruese sipas nenit 4 paragrafit 1.1 deri në paragrafin 1.18, si dhe subjektet deklaruese nga paragrafi 1.19 deri në paragrafin 1.38, 1/3 e subjekteve deklaruese ju kanë nënshtruar kontrollit sipas përzgjedhjes me short. Sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-108, 150 subjekte deklaruese iu kanë nënshtruar kontrollit sipas përzgjedhjes me short.

Procesi i kontrollit të plotë të pasurisë ka filluar duke bërë krahasimin e të dhënave të deklaruara ndër vite, krahasimin e të dhënave të pranuar nga institucionet tjera si: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Ministria e Financave- Departamenti i Tatimit në Pronë, Thesari, Ndërmarrjet Publike, Agjencia e Regjistrimit Civil, Administrata Tatimore e Kosovës, Universitetet Publike/Private dhe të tjera.

Rastet e bartura nga viti 2024 në vitin 2025 janë përfunduar nga kontrolli i plotë, dhe nga numri i përgjithshëm i subjekteve deklaruese që iu kanë nënshtruar kontrollit të plotë të pasurisë është realizuar për 1321 subjekte deklaruese, sipas obligimit ligjor që ka përcaktuar kontrollin e plotë.

Numri i rasteve të bartura	Rastet e mbyllura	Rastet e proceduara për kallëzime penale në Prokurori	Raste e proceduara si informatë në Prokurori	Rastet e dërguar qortime jo publike subjekteve deklaruese
1321	1246	17	58	38

Tabela Nr.13 --- pasqyron të dhënat nga kontrolli i plotë lidhur me rastet e përfunduara dhe të bartura nga viti 2024-2025.

Gjatë vitit 2025 kemi pranuar informacione edhe për 44 subjekte deklaruese, nga mediat dhe palët e treta 12 raste, dhe përmes platformës “Raporto Korrupsionin” kemi pranuar 32 raste. Nga numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara janë iniciuara 20 raste, 4 raste që kemi pranuar informacionet kanë qenë duke u zhvilluar kontrolli i plotë dhe i kemi bashkangjitur informacionin e pranuar, ndërsa 20 raste të pranuar përmes platformës nuk i kanë plotësuar kushtet për të filluar kontrollin e plotë.

Numri i rasteve të raportuara	Numri i rasteve që nuk janë iniciuar se nuk kanë pasur bazë	Numri i rasteve që kanë qenë duke u hetuar	Numri i rasteve që kemi filluar kontrollin	Të mbyllura	Të bartura për vitin 2026	Rastet e proceduara me informatë
44	20	4	20	10	7	3

Tabela Nr.14 --- pasqyron të dhënat nga kontrolli i plotë lidhur me rastet e dem-noncuara gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, kontrolli i pasurisë ka filluar për subjektet deklaruese sipas Ligjit nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave. Të gjitha subjektet deklaruese sipas nenit 4 paragrafit 1.1 deri në paragrafin 1.18, si dhe subjektet deklaruese nga paragrafi 1.19 deri në paragrafin 1.38, 1/3 e subjekteve deklaruese iu kanë nënshtruar kontrollit sipas përzgjedhjes me short.

Sipas obligimit ligjor	Të mbyllura	Të bartura 2025
1504	1251	253

Tabela Nr.15----- pasqyron të dhënat nga kontrolli i plotë gjatë vitit 2025 si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë

Vitet	Kontrolli i plotë	Rastet e mbyllura	Rastet e proceduara me kallëzim penal dhe informatë	Raste të bartura në vitin 2024	Rastet e trajtuara (ex-officio) sipas informatave anonime apo OJQ
2023	1735	19 (1.09%)	0	1716 (98.90%)	27
2024	1336	12	3	1321	12
2025	1504	1261	78	260	20

Tabela Nr. 16 pasqyron të dhënat nga kontrolli i plotë i pasurisë për tre vite 2023-2025

## DEKLARIMI I DHURATAVE TË PRANUARA NGA INSTITUCIONET

Bazuar në Ligjin nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Rregulloren Nr. 05/2024 për Pranimin dhe Regjistrimin e Dhuratave nga Personat Zyrtarë, institucionet obligohen t'i emërojnë zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të dhuratave. Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohet nga Agjencia dhe që mbahen nga institucioni, në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën.

### Rastet e trajtuara

Gjatë periudhës raportuese, përmes platformës “Raporto Korrupsionit” janë pranuar 2 raportime anonime lidhur me pranimin e dhuratave nga personat zyrtar. Të gjitha raportimet janë protokolluar dhe trajtuar në kuadër të kompetencave ligjore të Agjencisë. Pas trajtimit dhe shqyrtimit administrativ, njëri rast është mbyll me vendim, ndërsa tjetri rast vazhdon të jetë në procedurë trajtimi.

Po ashtu, gjatë vitit 2025, në Agjenci është pranuar një (1) kërkesë për lejimin e pranimit të dhuratës, e cila aktualisht është në procedurë shqyrtimi dhe trajtimi sipas dispozitave ligjore në fuqi. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Agjencia ka ofruar përgjigje zyrtare për gjithsej 6 institucione lidhur me pyetje dhe kërkesa për sqarim mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë pranimin e dhuratave.

### Dorëzimi i formularit të dhuratave

Për periudhën raportuese, sipas legjislacionit në fuqi Agjencia ka pranuar njoftime/raporte nga 206 zyrtarë kontaktues të institucioneve apo ndërmarrjeve publike që kanë obligim të dorëzojnë regjistrin e dhuratave në Agjenci. Prej tyre, 123 kanë deklaruar se gjatë vitit paraprak nuk kanë pranuar dhurata, ndërsa 37 zyrtarë kontaktues kanë deklaruar se në institucionet e tyre kanë pranuar dhurata. Kurse 31 zyrtarë kontaktues të institucioneve nuk kanë raportuar fare. Poashtu, vlen të theksohet se institucioni-Spitali i Vushtrisë, nuk ka caktuar zyrtar kontaktues.

### Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e regjistrin e dhuratave gjatë këtij viti për vitin paraprak

Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës (Zyra e Presidentit), Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Avokati i Popullit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës – Drejtoria për Kufirin, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia për Informim dhe Privatësi, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Agjencia për Barazi Gjinore, Akademia e Drejtësisë, Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Komuna e Ferizajt, Komuna e Pejës, Posta e Kosovës, Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini”.

Të dhënat e specifikuar lidhur me regjistrat e dhuratave sipas institucioneve që i kanë dorëzuar kopjet e regjistrave në APK, janë të paraqitura në tabelën në vijim;

<i>Nr.</i>	<i>Institucionet</i>	<i>Protokollare</i>	<i>Rastit</i>	<i>Numri i përgjithshëm</i>
1	Kuvendi i Kosovës	4		4
2	Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	1	11	12
3	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	5		5
4	Zyra e Kryeministrit të Kosovës	44	33	77
5	Avokati i Popullit	1	1	2
6	Zyra Kombëtare e Auditimit	3		3
7	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	71	37	108
8	Ministria e Punëve të Brendshme	1		1
9	Ministria e Punëve të Jashtme	14		14
10	Ministria e Financave	2	2	4
11	Ministria e Ekonomisë		1	1
12	Dogana e Kosovës	2		2
13	Policia e Kosovës – Drejtoria për Kufirin	1		1
14	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit		9	9
15	Agjencia për Informim dhe Privatësi	1		1
16	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës		3	3
17	Agjencia për Barazi Gjinore	1		1
18	Akademia e Drejtësisë	2		2
19	Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës	1	13	14
20	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	2		2
21	Komuna e Ferizajt	3	1	4
22	Komuna e Pejës	1		1
23	Posta e Kosovës	3	10	13
24	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini”	1		1
25	Zyra e Rregullatorit për Energji		10	10
<b>GJITHSEJ</b>		<b>164</b>	<b>121</b>	<b>285</b>

*Tabela Nr. 17 lidhur me regjistrat e dhuratave sipas institucioneve që i kanë dorëzuar kopjet e regjistrave në APK*

### **Institucionet të cilat kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit 2025**

Për vitin 2025 i kemi gjithsej 123 institucione të cilat se nuk kanë pranuar fare dhurata të renditura si më poshtë:

Kompania Rajonale e Ujësjellësit Gjakova Sh.A., Gjakovë, Komuna e Kamenicës (Dardanë), Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, Radio Televizioni i Kosovës, Ibër-Lepenci – Ndërmarrje

Publike Qendrore, Ndërmarrja Publike Hortikultura, Prishtinë, Komuna e Malishevës, Komuna e Klinës, Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë (IBCM), Komuna e Prishtinës, Prokuroria e Shtetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Spitali i Përgjithshëm në Pejë, Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastërtia”, Ferizaj, Universiteti “Isa Boletini”, Mitrovicë, Inspektorati Policor i Kosovës, Kompania Rajonale e Mbeturinave “Uniteti”, Mitrovicë, Ndërmarrja Publike “Trafiku Urban”, Prishtinë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, Komuna e Zveçanit, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Komuna e Lipjanit, Inspektorati i Punës, Komuna e Shtimes, Komuna e Mitrovicës së Veriut, Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës, Gjakovë, Komisioni i Pavarur i Mediave, Kompania Rajonale e Ujësjesit “Prishtina”, Ndërmarrja Publike Lokale “Sport Marketing” Sh.A., Prishtinë, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Hidroregjioni Jugor Sh.A., Prizren, Shëndeti Mendor i Kosovës, Agjencia për Ndhimë Juridike, Universiteti “Fehmi Agani”, Gjakovë, Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, Ndërmarrja Publiko-Komunale “Ekologjia”, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, Komuna e Mitrovicës së Jugut, Agjencia e Kosovës për Akreditim, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Ngrohtorja e Qytetit “Termokos”, Prishtinë, Agjencia për Arsimit dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve, Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, Prishtinë, Ministria e Shëndetësisë, Universiteti “Haxhi Zeka”, Pejë, Komuna e Parteshit, Ndërmarrja Publike Banësore, Prishtinë, Komuna e Rahovecit, Ndërmarrja Publike Lokale “Përparimi” Sh.A., Vushtrri, Komuna e Dragashit, Kompania Rajonale e Ujësjesit “Bifurkacion”, Ferizaj, Komuna e Novobërdës (Artanë), Kompania Rajonale e Mbeturinave “Ekoregjioni”, Komuna e Hanit të Elezit, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kompania Rajonale e Mbeturinave “Ambienti”, Pejë, Komuna e Junikut, Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, Agjencia Qendrore e Prokurimit, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren, Komuna e Vitisë, Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, Komuna e Shtërpçës, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Agjencia për Produkte dhe Pajisje Mjekësore, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë, Agjencia Pyjore e Kosovës, Qendra Kombëtare e Telemjekësisë, Kompania për Menaxhimin e Deponive, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Inspektorati i Arsimit, Komuna e Gjakovës, Agjencia e Kosovës për Forenzikë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, Komuna e Fushë Kosovës, Komuna e Podujevës, Kompania e Ujitjes “Drini i Bardhë”, Qendra e Studentëve, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Komuna e Vushtrrisë, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Telekomit i Kosovës, Ndërmarrja Publike Lokale “Qendra Multifunkionale” Sh.A., Mitrovicë, Komuna e Suharekës, Komuna e Zubin Potokut, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti për Integritet Evropian (ish-Ministria e Integritetit Evropian), Ndërmarrja Publike Lokale “Prishtina Parking” Sh.A., Prishtinë, Komuna e Obiliqit, Agjencia për Shërbimin e Navigacionit Ajror, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Autoriteti i Aviacionit Civil, Kompania Rajonale e Mbeturinave “Çabradi”, Gjakovë, NP “Infrakos” Sh.A., Komuna e Deçanit, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Komuna e Glllogocit (Drenas), NP “Trainkos” Sh.A., Instituti Albanologjik, Policia e Kosovës, Drejtoria Rajonale Prishtinë, Drejtoria Rajonale Gjakovë, Drejtoria Rajonale Mitrovicë e Jugut, Drejtoria Rajonale Mitrovicë e

Veriut, Drejtoria Rajonale Prizren , Drejtoria Rajonale Pejë, Drejtoria Rajonale Ferizaj, Drejtoria Rajonale Gjilan.

### **Institucionet të cilat nuk kanë raportuar**

Agjencia e Inteligjencës së Kosovës, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik, Komuna e Gjilanit, Komuna e Kaçanikut, Komuna e Istogut, Komuna e Ranillugut, Komuna e Leposaviçit, NPL Pallati i Rinisë sh.a., Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina sh.a., Ndërmarrja Publike Tregu Mitrovicë e Jugut, Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë, NPL Kastrioti Sh.A, Ambienti Ferizaj, Universiteti Publik i Gjilanit, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidromorava sh.a., Gjilan, Trepça Sh.A, Ministria e Mbrojtjes, Spitali i Përgjithshëm Vushtrri, Spitali i Përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” Prizren, Fondi i Sigurimit Shëndetësor, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Agjencia Shtetërore e Arkivave.

Përgjatë periudhës raportuese, Agjencia ka zhvilluar edhe procesin e inspektimit dhe auditimit të dhuratave duke vizituar 22 institucione lidhur me mbajtjen dhe regjistrimin e dhuratave të deklaruara nga personat zyrtar të këtyre institucioneve për vitin paraprak janar-dhjetor 2024. Ky aktivitet u realizua brenda periudhës kohore 30.06.2025 deri 15.08.2025.

Poashtu është bërë kontrollë dhe verifikim sa i përket ekspozimit të dhuratave sipas legjislacionit në fuqi, në këndin e veçantë dhe të qasshëm për palët dhe publikun. Si rezultat, nga 22 institucione të vizituara, 21 prej tyre i kanë të siguruar këndet e dhuratave, ndërsa vetëm 1 nga këto institucione nuk e ka siguruar këndin e dhuratave.

Institucionet që kanë siguruar këndin e dhuratave janë: *Zyra e Presidentes, Kuvendi i Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Akademia e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, , Banka Qendrore e Kosovës, Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Posta e Kosovës, Telekomit i Kosovës, Dogana e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, QKUK-SHSKUK, Komuna e Ferizajt, Komuna e Pejës, Gjykatën Supreme.*

Ndërsa, institucioni i cili nuk kishte siguruar këndin e dhuratave është Ministria e Punëve të Brendshme.

## VLERËSIMI I RREZIKUT DHE I AKTEVE LIGJORE KUNDËR KORRUPSION

Sipas nenit 26, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia bën vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në fusha apo sektorë të ndryshëm.

Për ushtrimin e kësaj kompetence, Agjencia, gjatë vitit raportues 2025, ka iniciuar procesin e vetëvlerësimit të performancës kundër korrupsionit në fushat: politikat kundër korrupsionit, konflikti i interesit, deklarimi i pasurisë dhe interesave, si dhe mbrojtja e sinjalizuesve. Ky proces është zhvilluar në përputhje me Udhëzuesin e përgatitur nga Rrjeti kundër Korrupsionit i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, në kuadër të Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit të Stambollit, Raundi i 5-të i Monitorimit (<https://apk-rks.net/neës/apk-nis-procesin-e-vetevleresimit-te-performances-kunder-korrupsionit-sipas-standardeve-te-oecd-se/>).

Përgjatë këtij vlerësimi janë ndërmarrë një sërë aktivitete të rëndësishme për zhvillimin e tij dhe për sigurimin dhe mbledhjen e informacionit dhe dokumentacionit nga institucionet relevante shtetërore, ku përfshihen të dhëna, përgjigje në pyetësor dhe dëshmi mbështetëse.

Udhëzuesi fillimisht është përshtatur me kontekstin e Kosovës, ndërsa edhe gjatë fazës së zbatimit, është vijuar me përshtatjen e mëtejme të tij.

Më pas është analizuar pyetësori, i cili po ashtu duhej të përshtatej para shpërndarjes te institucionet relevante, për sigurimin dhe mbledhjen e informacionit dhe dokumentacionit të saktë dhe cilësor, mbi treguesit e caktuar të fushave të performancës të përfshira në këtë vlerësim.

Janë identifikuar institucionet shtetërore, si subjekte të cilat kanë mundur të ofrojnë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas udhëzuesit të lartcekur duke synuar përfshirje të gjerë, personat e tyre përgjegjës dhe kontaktet e tyre. Pyetësori është shpërndarë te:

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, njësitë përkatëse të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe 7 (shtatë) Gjykatat Themelore në nivel të Republikës së Kosovës së bashku me degët e tyre.

Shpërndarja e pyetësorit u shoqërua me kontaktimin e personave përgjegjës të institucioneve, të cilëve iu kërkua të konfirmojnë pranimin e tij. Institucionet ishin përgjegjëse për plotësimin e pyetësorëve dhe për ofrimin e dëshmime mbështetëse. Afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për përgjigje u konsiderua fleksibil, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e veçanta të disa institucioneve. Gjatë gjithë procesit, zyrtarët përgjegjës të Agjencisë mbajtën kontakte të rregullta me zyrtarët përkatës të institucioneve, me qëllim të sigurimit dhe mbledhjes së informacionit dhe të dhënave sa më të sakta dhe cilësore.

Një pjesë e rëndësishme e procesit përfshiu ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për përfaqësuesit e institucioneve në plotësimin e pyetësorëve, duke organizuar gjashtë (6) takime për të shpjeguar udhëzuesin, pyetësorin dhe rëndësinë e vlerësimit. Takimet shërbyen edhe për informimin e

përfaqësuesve të institucioneve shtetërore mbi rolin e tyre në proces, si dhe për angazhimin e tyre në për plotësimin e pyetësorit dhe ofrimin e të dhënave të nevojshme.

Pas grumbullimit të informacionit (përgjigje në pyetësorë, të dhëna dhe dëshmi mbështetëse) nga institucionet përkatëse, gjatë vitit pasues (2026) do të vijojë procesi i nisur i verifikimit dhe analizimit të të dhënave të siguruara, si dhe përgatitja e rezultateve të vlerësimit. Vlerësimi parashikon gjithashtu përfshirjen e shoqërisë civile, e cila do të sjellë vlerë të shtuar.

### **Vlerësimi i akteve ligjore kundër korrupsionit**

Vlerësimi i akteve ligjore kundër korrupsionit parashikohet gjithashtu si masë parandaluese, e cila, sipas nenit 27, paragrafi 1 të Ligjit nr. 08/L-017, përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve dhe zbrazëtirave në projektligjet, projekt aktet nënligjore, aktet ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim, të cilat mund të rrisin potencialisht korrupsionin, si dhe pajtueshmërinë e tyre me me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit.

Për vitin 2025, Agjencia, me vetiniciativë dhe në përputhje me dispozitat e nenit 27 të Ligjit nr. 08/L-017, si dhe duke u bazuar në Metodologjinë për vlerësimin e korrupsionit në legjislacion, të miratuar nga Agjencia në vitin 2023, ka zhvilluar planin orientues për qëllimet e këtij vlerësimi, duke parashikuar projekt-aktet dhe aktet normative për vlerësim.

Rezultatet nga hartëzimi i rrezikut të korrupsionit i realizuar nga Agjencia në vitin 2024, kanë orientuar zhvillimin e planit të vlerësimit në sektorët e poentuar si më të ndjeshëm dhe më të ekspozuar ndaj korrupsionit. Projekt-aktet dhe aktet normative janë identifikuar duke analizuar me kujdes Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2025–2027 dhe të Planet e Akteve Nënligjore, si dhe pas mbajtjes së katër (4) takimeve zyrtare me zyrtaret përgjegjës të Departamenteve Ligjore të Ministrive sponsorizuese.

Projekt-aktet dhe aktet normative të identifikuara për vlerësim, janë të renditura si më poshtë:

- Ligji për ndërmarrjet Publike (dispozitat për përzgjedhjen e KE së ndërmarrjeve Publike);
- Ligji nr. 08/L-249 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Projekt Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- Rregulloren (QRK) Nr. 03/2025 për kushtet bartjes së pronësisë së pronës publike dhe dhënia me qira e sendeve në pronësi publike;
- Udhëzimi Administrativ QRK- nr. 06/2018 për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik;
- Udhëzimi Administrativ nr. 01/2019 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimi për Kategorinë e III-të të Ndërtimeve;
- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr.03/2024 për Kriteret për Zgjedhjen e Lokacionit të Deponive si dhe Kushtet Teknike sipas Destinimit të tyre;
- Draft Udhëzimi Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/ 2022 për Leje Mjedisore;

- Draft Udhëzimi Administrativ (MINT) Nr. 00 /2025 për Përcaktimin e Standardeve dhe Mënyrën e Verifikimit të Cilësisë së Karburanteve dhe Produkteve të Naftës;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrit të Lejeve të Lëshuara;
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Procedurën e Gradimit të Personelit Policor.

Me përjashtim të Projekt Udhëzimit Administrativ për Procedurën e Gradimit të Personelit Policor, të gjitha të tjerat janë vlerësuar dhe Opinionet me rekomandime janë përcjell te autoritet përkatëse sponsorizuese.

(Sipas njoftimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme me datë 21.08.2025, Departamenti Ligjor ka përcjellë për nënshkrim në Zyrën e Sekretares së Përgjithshme, vendimin për themelimin e grupit punues për Projekt Udhëzimi Administrativ për Procedurën e Gradimit të Personelit Policor. Duke pasur parasysh këtë, Agjencisë nuk i është ofruar ndonjë draft i caktuar për vlerësim dhe jemi në pritje të njoftimit rreth draftimit të të njëjtit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.)

Gjatë procesit të vlerësimit, Agjencia ka kërkuar informacionet e nevojshme nga institucionet sponsorizuese dhe zbatuese të projekteve dhe akteve normative, të cilat kanë ofruar bashkëpunim e tyre. Ndër të tjera, vlerësimi gjithashtu ka përfshirë edhe analizimin e legjislacionit në fuqi dhe atij të shfuqizuar, si dhe çdo dokument tjetër vendor dhe ndërkombëtar me relevancë.

Në tremujorin e fundit të vitit raportues, Agjencia ka pranuar një kërkesë për vlerësim nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me Projektligjin për Mbrojtjen e Natyrës, vlerësimi i të cilit vazhdon edhe në fillim të vitit 2026.

## **Planet e Integritetit**

Gjatë vitit 2025, Agjencia, ka ushtruar një rol të rëndësishëm në forcimin e mekanizmave të integritetit institucional. Ky kontribut është realizuar përmes monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit, avancimit të kornizës metodologjike dhe strategjike në fushën e parandalimit të korrupsionit, mbështetjes dhe ndërtimit të kapaciteteve të institucioneve publike, si dhe përmes pjesëmarrjes aktive në procesin e përditësimit të Planeve të Integritetit të institucioneve përgjegjëse.

Në kuadër të zbatimit të rregullt të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të Planeve të Integritetit, gjatë muajit korrik 2025, është iniciuar procesi i raportimit për periudhën janar–qershor 2025. Me këtë rast, zyrtarëve përgjegjës për integritet në institucionet publike u është përcjellë njoftim zyrtar elektronik, përmes të cilit janë udhëzuar që, në përputhje me Udhëzuesin për Monitorimin dhe Raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit, të përpilojnë dhe dorëzojnë raportet me shkrim mbi epilogun e zbatimit të masave të Planit të Integritetit.

Institucionet janë njoftuar se raportet duhet të dorëzohen në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit deri më 31 korrik 2025, ndërsa si dokument referues obligativ është përdorur Udhëzuesi i ndryshuar dhe plotësuar i datës 19.08.2024. Ky proces ka shërbyer si bazë për vlerësimin e progresit institucional, identifikimin e sfidave në zbatimin e masave të integritetit dhe sigurimin e të dhënave analitike.

Raportet e pranuar janë trajtuar dhe analizuar, duke kontribuar në krijimin e një pasqyre të qartë mbi gjendjen reale të zbatimit të Planeve të Integritetit në nivel institucional.

Nga analiza e realizuar rezulton se:

- 108 institucione kanë raportuar në mënyrë të rregullt dhe brenda afatit ligjor;
- 15 institucione nuk kanë dorëzuar fare raporte;
- 1 institucioni i është refuzuar raporti për mospërputhje metodologjike;
- 15 institucione nuk kanë hartuar Plane të Integritetit;
- 13 institucione kanë raportuar, por raportet kërkojnë përditësim përmbajtësor.

Këto të dhëna tregojnë nivel të kënaqshëm të përfshirjes institucionale, por njëkohësisht evidentojnë mangësi strukturore në cilësi, zbatim dhe raportim.

Institucionet që nuk kanë dorëzuar raportet e tyre gjashtë mujore brenda afatit ligjor janë: Agjencia e Kosovës për Akreditim; Agjencia e Metrologjisë së Kosovës; Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar; Agjencia Qendrore e Prokurimit; Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës; Inspektorati Qendror i Punës; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Komunitet Dragash, Gjakovë, Hani i Elezit, Partesh, Prishtinë dhe Zveçan; Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”; Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. Mos raportimi përbën shkelje të obligimeve ligjore dhe metodologjike, si dhe ndikon negativisht në vlerësimin e progresit institucional.

Në bazë të procesit të raportimit, Agjencia ka hartuar dy dokumente analitike. Përmbledhjen e Raportimit janar–qershor 2025, që pasqyron nivelin e përmbushjes, progresin, sfidat dhe nevojat për ndërhyrje korrigjuese si dhe Indeks të Integritetit nëpër Komuna, instrument analitik për vlerësimin krahasues të komunave lidhur me zbatimin e Planeve të Integritetit, transparencën dhe masat parandaluese kundër korrupsionit.

Në funksion të përmirësimit të cilësisë së përditësimit të Planeve të Integritetit për vitin 2026 ndër të tjera, gjatë datave 21–23 tetor 2025, Agjencia ka organizuar punëtori njëditore për zyrtarët përgjegjës për integritet nga mbi 100 institucione publike. Punëtoritë kanë qenë të natyrës interaktive dhe kanë adresuar hapat, afatet, raportimin, monitorimin, sfidat kryesore në zbatimin e planeve ekzistuese dhe përditësimin. Gjatë datave 27–29 tetor 2025, Agjencia ka organizuar punëtori të brendshme për përditësimin e Planit të Integritetit të Agjencisë, duke analizuar rreziqet, masat parandaluese dhe përgjegjësitë organizative, me qëllim rritjen e integritetit institucional dhe dhënien e shembullit për institucionet tjera.

Po ashtu, është përditësuar Udhëzuesi për Monitorimin dhe Raportimin e Planit të Integritetit, me përfshirjen e kapitullit të ri “Përditësimi i Planit të Integritetit”, në përputhje me nenin 25 të Ligjit Nr. 08/L-017, si dhe është iniciuar procedura për amendamentimin formal të tij.

Më 17 nëntor 2025, të gjithë zyrtarët përgjegjës për integritet janë njoftuar zyrtarisht për detyrimin dhe procedurat për përditësimin e Planeve të Integritetit, me afat përfundimtar deri në fund të janarit 2026, duke u ofruar materiale, udhëzuese dhe shembuj praktikë.

Në muajin maj 2025, është organizuar edhe një punëtori për draftimin e Metodologjisë për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, me qëllim krijimin e një kornize të qartë, të matshme dhe të qëndrueshme për monitorim strategjik dhe raportim të bazuar në evidencë.

## BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE

Në kuadër të periudhës raportuese janar-dhjetor 2025, dhe në zbatim të mandatit e detyrimeve ligjore, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka zhvilluar bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet vendore relevante për të zbatuar sa më suksesshëm fushën e veprimtarisë së saj. Ky bashkëpunim ka përfshirë zhvillimin e takimeve të ndryshme, angazhimin në trajtim të legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe realizimin e veprimeve të tjera të nevojshme për përmbushjen e kërkesave dhe nevojave institucionale të Agjencisë. Aktivitetet dhe përfaqësimet në nismat e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me institucionet vendore të nivelit të lartë janë udhëhequr nga Drejtori i Agjencisë, si më poshtë:

- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), z. Yll Buleshkaj, mori pjesë në prezantimin e “Doracakut për Parandalimin e Korrupsionit”, organizuar nga OJQ Aktiv në Mitrovicën e Veriut./16 Janar 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) organizoi takime me institucione publike, ndërmarrje shtetërore dhe shoqëri civile për diskutimin e gjetjeve dhe mësimet nga Hartëzimi i Rrezikut të Korrupsionit (HRrK)./27-29 Janar 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, organizoi një punëtori dyditore për zyrtarët mbi kornizën e propozuar të Udhëzimit Metodologjik mbi Konfliktin e Interesit./31 Janar 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), me mbështetjen e Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP), zhvilloi punëtorinë e parë të ciklit katërditor të trajnimeve për zyrtarët kontaktues mbi procesin e deklarimit të pasurisë dhe dhuratave për vitin 2025./4 Shkurt 2025/
- Përfundoi ciklin katërditor të trajnimeve për zyrtarët kontaktues mbi deklarimin e pasurisë dhe dhuratave për vitin 2025, i organizuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me mbështetjen e IKAP./7 Shkurt 2025/
- Kosova iu nënshtrua vlerësimit vullnetar të OECD për Public Integrity Indicators, ku morën pjesë 22 shtete të OECD dhe 6 shtete jashtë saj, përfshirë Kosovën. Rezultatet tregojnë se Kosova prin mbi mesataren e shteteve të OECD dhe Bashkimit Evropian në dy grupet e para të indikatorëve, përveç rregullimit të lobimit./7 Shkurt 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mirëpriti përmirësimin e renditjes së Kosovës në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit 2024. Ky rezultat tregon progres të dukshëm dhe nënvizon nevojën për vazhdimin e përpjekjeve./11 Shkurt 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) organizoi takim me OSHC-të për shqyrtimin kundër korrupsionit të akteve ligjore. Diskutimet përfshinë zgjatjen e shqyrtimit për ligjet e Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor, publikimin e opinionëve dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve./7 Mars 2025/

- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Yll Buleshkaj, priti Ambasadorin e Holandës në Kosovë, znj. Karin Boven. Takimi u fokusua në bashkëpunimin për parandalimin e korrupsionit, transparencën dhe mbrojtjen e sinjalizuesve./14 Mars 2025/
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Yll Buleshkaj, ishte mysafir i podcastit të organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), ku foli për verifikimin e interesave të zyrtarëve publikë dhe kufizimet që ata kanë gjatë ushtrimit të funksioneve publike./26 Mars 2025/
- Përfaqësues të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), Lindita Ademi dhe Afrim Atashi, morën pjesë në tryezën e organizuar nga Group for Legal and Political Studies mbi rastet e korrupsionit në vitin 2024. Ata shprehën shqetësimin për trajtimin e rasteve nga gjykatat dhe mosnjohjen e APK-së si palë e dëmtuar./27 mars 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) organizoi aktivitet me zyrtarët e rinj të institucioneve publike për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve. Qëllimi ishte forcimi i mekanizmit të sinjalizimit si mjet kundër korrupsionit dhe për nxitjen e integritetit./16 Prill 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit zhvilloi ligjëratë-diskutim me studentët e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës. Drejtori i APK-së, z. Yll Buleshkaj prezantoi mandatin e Agjencisë dhe shpjegoi procesin e deklarimit të pasurisë, kontrollin e dhuratave dhe parandalimin e konfliktit të interesit./30 Prill 2025/
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Yll Buleshkaj, realizoi vizitë pune në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, ku u prit nga ushtruesi i detyrës së drejtorit, z. Alban Sutaj. Gjatë takimit u theksua rëndësia e menaxhimit transparent dhe efikas të pasurive të përfituara në mënyrë të kundërligjshme./30 Prill 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) realizoi ligjëratë-diskutim me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës. Zëvendësdrejtori z. Liridon Nika prezantoi mandatin e Agjencisë, ndërsa Afrim Atashi dhe Esad Ejupi shpjeguan aspektet praktike të deklarimit të pasurisë, dhuratave dhe parandalimin e konfliktit të interesit./15 Maj 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me mbështetjen e OSBE-së, zhvilloi punëtori tre-ditore në Gjakovë për finalizimin e Metodologjisë së Monitorimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit./19-21 Maj 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me mbështetjen e OSBE-së, organizoi dy trajnime të avancuara dyditore mbi trajtimin e rasteve të sinjalizimit. Në trajnime morën pjesë mbi 53 zyrtarë nga institucione publike, ndërmarrje publike dhe komuna./26-27 dhe 28-29 Maj 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit zhvilloi një bashkëbisedim me nxënësit e Gjimnazit "Ahmet Gashi" në Prishtinë. Gjatë takimit u diskutua për transparencën, integritetin dhe rolin e të rinjve në parandalimin e korrupsionit./30 Maj 2025/
- Zyrtarët përgjegjës për rastet e sinjalizimit në institucione publike kanë filluar të ndërmarrin hapa konkretë për vetëdijesimin e kolegëve mbi këtë mekanizëm. Deri tani nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) janë mbajtur mbi 15 takime informuese në institucione të ndryshme, duke përfshirë komuna, agjenci dhe prokurori. APK mbetet e përkushtuar në mbështetjen e zyrtarëve dhe zgjerimin e rrjetit profesional në të gjitha institucionet publike./13 Qershor 2025/

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së, organizoi dy cikle trajnimesh dyditore mbi trajtimin e rasteve të sinjalizimit, me mbi 45 zyrtarë nga institucione dhe ndërmarrje publike. Pjesëmarrësit u angazhuan në analizimin e rolit të sinjalizimit, shqyrtimin e kuadrit ligjor, ushtrime praktike dhe shkëmbimin e përvojave ndërinstytucionale./17-20 Qershor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përfaqësuar nga z. Liridon Nika, Zëvendësues i Drejtorit, mori pjesë në punëtorinë pas-zgjedhore të organizuar nga KQZ dhe Komisioni i Venecias në Prishtinë. Z. Nika theksoi se APK shqyrton raportet financiare të audituara të partive dhe donacionet nga zyrtarët publikë, duke analizuar gjithashtu rastet nga këndvështrimi i konfliktit të interesit./26 Qershor 2025/
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Yll Buleshkaj, priti Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin Ekonomik, Prokurorin Kujtim Munishi. Takimi u fokusua në fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstytucional për avancimin e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik në Kosovë./1 Korrik 2025/
- Zyrtarët përgjegjës për trajtimin e sinjalizimeve të brendshme mbajtën 29 takime informuese gjatë muajit qershor në institucione të ndryshme publike në Kosovë. (Takimet janë mbajtur në këto institucione: Instituti i Mjekësisë Ligjore, Sekretariati i Këshillit të Sigurisë, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, Stacioni i Autobusëve Ferizaj, Posta e Kosovës, Komuna e Rahovecit, Komuna e Leposaviqit, Agjencia për Shërbimin e Navigacionit Ajror, Dogana e Kosovës, Komuna e Fushë Kosovës, Prishtina Parking, Ministria e Zhvillimit Rajonal, NPL Stacioni i Autobusëve Prishtinë, Gjykata Themelore Prishtinë, Kuvendi i Kosovës, Gjykata e Apelit, Komuna e Podujevës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Gjykata Themelore Ferizaj, KRM "Uniteti" Mitrovicë, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Shtetërore e Arkivave, Agjencia për Barazi Gjinore, Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj, Institucioni i Avokatit të Popullit, Administrata Tatimore e Kosovës)./3 Korrik 2025/
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Yll Buleshkaj zhvilloi një bisedë me përfaqësuesit e organizatës ORCA në kuadër të projektit HEI25, për transparencën financiare në universitete publike dhe përmirësimin e sistemit të deklarimit të pasurisë. APK do të bashkëpunojë në publikimin e gjetjeve dhe në thellimin e bashkëpunimit institucional./8 Korrik 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, e udhëhequr nga Drejtori Yll Buleshkaj, u takua me Akademinë e Drejtësisë, të përfaqësuar nga Drejtori Enver Fejzullahu, për të thelluar bashkëpunimin ndërinstytucional./1 Gusht 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) publikoi raportin 6 mujor për sinjalizimin në Kosovë (Janar - Qershor 2025). Nga 199 institucione publike, 157 kanë raportuar, ndërsa 42 ende jo. Gjatë kësaj periudhe janë gjithsej 62 raste të sinjalizimit të brendshëm./4 Gusht 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në bashkëpunim me Democracy Plus dhe me mbështetjen e Fondit të Kanadasë për Iniciativa Lokale (CFLI), themeloi Shkollën për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit. Programi synon fuqizimin e të rinjve përmes njohurive dhe aftësive praktike në fushën e integritetit dhe parandalimit të korrupsionit, duke ofruar mundësi për punë praktike profesionale në APK për pjesëmarrësit më të dalluar./11 Gusht 2025/

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mirëpriti pjesëmarrësit e Shkollës së organizuar nga KDI – GO4IT, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Ambasada Suedeze në Kosovë. Drejtori i APK-së, Yll Buleshkaj, prezantoi mandatin dhe rolin e APK-së, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në forcimin e integritetit dhe transparencës./12 Gusht 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, organizoi një punëtori mbi rolin e sinjalizuesve dhe mbrojtjen e tyre ligjore. Në aktivitet morën pjesë zyrtarë nga komunat shqiptare dhe serbe, por edhe institucione të ndryshme publike qendrore, ndërsa diskutimet u fokusuan në detyrimet ligjore, kanalet e raportimit dhe forcimin e mekanizmave të sinjalizimit për parandalimin e korrupsionit./15 Gusht 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi për zhvillimin e një moduli online mbi parandalimin e konfliktit të interesit. Moduli synon forcimin e njohurive dhe profesionalizmit të zyrtarëve publikë, përmes përmbajtjeve praktike dhe certifikimit elektronik, me mbështetjen e Qeverisë Gjermane./20 gusht 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit i ndau mirënjohje z. Xheladin Grajqevci, Udhëheqës i Sektorit të Sigurisë së IT-së në ASHI, për angazhimin dhe mbështetjen në implementimin e platformës elektronike “Raporto Korrupsionin”. Falënderimi u shtri edhe për stafin e ASHI-së, duke u theksuar roli i transparencës dhe inovacionit teknologjik në luftën kundër korrupsionit./21 Gusht 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nisi themelimin e Forumit Konsultativ me Organizatat e Shoqërisë Civile, si platformë për dialog dhe veprim të përbashkët kundër korrupsionit. Forumi synon forcimin e rolit të shoqërisë civile dhe avancimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në Kosovë./4 Shtator 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nisi bashkëpunimin me projektin MATRA, të zbatuar nga Lëvizja FOL dhe Democracy Plus, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë. Me këtë rast, drejtori i APK-së, z. Yll Buleshkaj, priti përfaqësuesit e organizatave partnere për të diskutuar monitorimin e planeve të integritetit dhe forcimin e llogaridhënies institucionale./9 Shtator 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit zhvilloi një bashkëbisedim me maturantët e Gjimnazit “Aleksandër Xhuvani”, në Podujevë, ku u diskutua mbi misionin e saj, rëndësinë e integritetit dhe rolin e të rinjve në parandalimin e korrupsionit. Zyrtarët e APK-së inkurajuan të rinjtë që të kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhme më të drejtë dhe institucione më të forta./12 Shtator 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mbajti në Podujevë një punëtori tre-ditore mbi Raportin Përmbledhës të Zbatimit të Planeve të Integritetit 2025 dhe amendamentimin e udhëzuesit për monitorim dhe raportim. Aktiviteti u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Kosovë./9-11 Tetor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit organizoi në Prishtinë tri punëtori njëditore mbi përditësimin e Planeve të Integritetit, me mbështetjen e OSBE-së. Mbi 100 zyrtarë qendrorë dhe lokalë morën pjesë në ushtrime praktike për identifikimin e rreziqeve dhe përmirësimin e masave parandaluese. Në punëtori u prezantua edhe qasja e re metodologjike e Agjencisë për hartimin dhe përditësimin e planeve të integritetit./21-23 Tetor 2025/

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit zhvilloi një ligjëratë-diskutim me gjimnazistët e Shkollës “Dr. Shaban Hashani” në Ferizaj për ndershmëri, transparencë dhe përgjegjësi qytetare. Nxënësit diskutuan dhe shtruan pyetje mbi rëndësinë e integritetit dhe rolin e tyre në parandalimin e korrupsionit./23 Tetor 2025/
- Raporti GLPS RoLPIK 2025 vlerëson Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit me notën 3 dhe evidenton rritje prej 8.7% të besimit qytetar për raportim. APK i fton qytetarët të raportojnë raste të korrupsionit për një Kosovë pa korrupsion./23 Tetor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit thelluan bashkëpunimin për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit institucional. Katër sesione ndërinstitucionale përfshinë mbi 120 zyrtarë, duke trajtuar konfliktin e interesit dhe praktikën e auditimit. Ky bashkëpunim synon rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike./25 Tetor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmbylli punëtorinë dy-ditore në Istog për testimin e Sistemit Digjital të Menaxhimit të Shërbimeve (DMSA). Sistemi përfshin E-Deklarimin, administrimin e dhuratave, sinjalizimin, konfliktin e interesit, planet e integritetit dhe vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni. Ky hap rrit transparencën, efikasitetin dhe përputhshmërinë me standardet evropiane./28 Tetor 2025/
- Ka nisur gjenerata e parë e Shkollës për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit, duke bashkuar të rinj nga e gjithë Kosova për të mësuar dhe vepruar për një shoqëri më të drejtë. Pjesëmarrësit thelluan njohuritë për kuadrin ligjor kundër korrupsionit, deklarimin e pasurisë dhe rolin e APK-së, si dhe diskutuan mbi mediat, shoqërinë civile dhe praktikën e transparencës. Shkolla u organizua nga Democracy Plus dhe APK, me mbështetjen e CFLI-së./31 Tetor 2025/
- Shkolla për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit përfundoi me sesione mbi konfliktin e interesit dhe sinjalizimin si mjet kyç kundër korrupsionit. Pjesëmarrësit u thelluan në praktikën e identifikimit dhe menaxhimit të konflikteve, si dhe në rolin e sinjalizuesve për mbrojtjen e interesit publik. Shkolla u organizua nga Democracy Plus dhe APK, me mbështetjen e CFLI-së./1-2 Nëntor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit organizoi në Pejë dy punëtori njëditore me mbi 30 zyrtarë nga institucione të ndryshme për diskutimin e rasteve konkrete dhe praktikave më të mira për menaxhimin e konfliktit të interesit. Aktiviteti, i mbështetur nga OSBE në Kosovë, synoi forcimin e integritetit dhe transparencës në administratën publike./11-13 Nëntor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe OSBE organizuan një punëtori me 17 institucione publike për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe harmonizimin me Direktivën e BE-së 2019/1937. Diskutimet u fokusuan te përgjegjësia, mbrojtja e menjëhershme dhe mbështetja juridike për sinjalizuesit. Ky aktivitet forcon transparencën dhe integritetin në administratën publike të Kosovës./21-22 Nëntor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), në bashkëpunim me Demokraci Plus, organizoi një vizitë studimore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP) për të rinjtë e Shkollës për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit. Pjesëmarrësit u informuan për mandatin, bazën ligjore dhe praktikën e AIP-së në mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike, duke u theksuar rëndësia e transparencës dhe integritetit institucional./27 Nëntor 2025/

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) dhe Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi për forcimin e integritetit publik dhe zhvillimin profesional të studentëve. Partneriteti trevjeçar parasheh trajnime, aktivitete të përbashkëta dhe angazhim praktik të studentëve në projektet e APK-së. Drejtori i APK-së, Buleshkaj, theksoi se bashkëpunimi afron institucionet me komunitetin akademik dhe krijon vlerë të qëndrueshme për publikun, duke rritur integritetin, komunikimin profesional dhe mundësitë për të rinjtë./3 Dhjetor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ishte në fokus të Projektit PECK III, të bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Drejtori Yll Buleshkaj prezantoi në panel rezultatet, arritjet dhe gjendjen e integritetit në sektorin publik. Projekti u vlerësua si shembull i reformave me ndikim real në forcimin e integritetit institucional. APK falënderoi BE-në dhe Këshillin e Evropës për mbështetjen dhe partneritetin e vazhdueshëm./10 Dhjetor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) mirëpriti raportin e IKD-së mbi ndikimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme në rastet e mosdeklarimit të pasurisë. Drejtori i Departamentit në APK, Afrim Atashi, theksoi rëndësinë e zbatimit korrekt të ligjit dhe ruajtjes së integritetit të sistemit të deklarimit të pasurisë, duke falënderuar IKD-në për kontributin profesional./11 Dhjetor 2025/
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), z. Yll Buleshkaj, me bashkëpunëtorë, u prit nga udhëheqësia dhe stafi i Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës. Takimi u përqendrua në zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe u dakordua hartimi i një plani të përbashkët aktiviteteve për vitin 2026, me qëllim forcimin e bashkëpunimit akademik dhe institucional./18 Dhjetor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) nisi procesin e vetëvlerësimit kundër korrupsionit, në përputhje me standardet e OECD-së. Procesi synon forcimin e integritetit dhe transparencës institucionale përmes identifikimit të fushave me rrezik të lartë për korrupsion, duke u mbështetur në bashkëpunim ndërinstytucional dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë./19 Dhjetor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) hap thirrjen për aplikim në sesionin e dytë për Shkollën për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit 2026. Programi organizohet nga Democracy Plus në bashkëpunim me APK-në dhe me mbështetjen e Ambasadës së Kanadasë në Kroaci dhe Kosovë. Kjo shkollë synon të pajisë studentët me njohuri, mjete praktike dhe aftësi kritike për promovimin e integritetit, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë./26 Dhjetor 2025/.

## **BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONE TË HUAJA**

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) gjithë vitin ka punuar dhe vepruar në drejtim të rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar, i cili është realizuar përmes përfaqësimit dhe pjesëmarrjes aktive të Drejtorit dhe stafit të Agjencisë në aktivitete të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Këto aktivitete kanë përfshirë vizita ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe ngjarje të nivelit rajonal. Qëllimi kryesor i këtij angazhimi ka qenë përfaqësimi institucional i Agjencisë, si dhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

- Një delegacion i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) vizitoi MENAC në Portugali, ku u prit nga Presidenti Dr. António Pires Henriques da Graça dhe stafi i institucionit. Vizita u zhvillua në kuadër të Projektit BACPE për shkëmbimin e praktikave më të mira kundër korrupsionit, duke mundësuar diskutime për përfshirjen e sektorit privat, programe pajtueshmërie, mekanizma sinjalizimi, trajnime për zyrtarët dhe përdorimin e teknologjisë për transparencë. Mësimet e nxjerra do të fuqizojnë kapacitetet e APK-së dhe efektivitetin e saj në luftën kundër korrupsionit në Kosovë./12 Shkurt 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) falënderoi Ambasadorin Edona Maloku Bërdyna dhe stafin e Ambasadës së Kosovës në Lisbonë për pritjen, duke diskutuar mundësitë e bashkëpunimit Kosovë-Portugali në parandalimin e korrupsionit./12 Shkurt 2025/
- Një delegacion i APK-së, i udhëhequr nga drejtori z. Yll Buleshkaj, zhvilloi vizitë studimore në Agjencinë Kundër Korrupsionit të Francës (AFA) në kuadër të projektit BACPE. U shkëmbyen praktika për kornizën rregullatore, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe për e-learning dhe edukim, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve të APK-së në luftën kundër korrupsionit./20 Shkurt 2025/
- Një delegacion i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), i udhëhequr nga drejtori Yll Buleshkaj, zhvilloi vizitë studimore në Romë së bashku me përfaqësues të shoqërisë civile dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit. Vizita u organizua me mbështetjen e projektit PECK III të Këshillit të Evropës, bashkëfinancuar nga CoE dhe BE. Gjatë ditës së parë, delegacioni vizitoi Shkollën Kombëtare të Administratës (SNA), ku u diskutua roli i edukimit dhe bashkëpunimit me ANAC në parandalimin e korrupsionit.
- Gjatë vizitës studimore në Romë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vizitoi Gjykatën e Auditorëve dhe u takua me drejtues e këshilltarë institucionalë. Diskutimet u fokusuan në rolin e Gjykatës në parandalimin e korrupsionit, bashkëpunimin me ANAC, përgjegjësinë administrative e penale, rikuperimin e fondeve publike dhe komunikimin antikorrupsion. Takimi mundësoi shkëmbimin e përvojave dhe mësimet nga praktika të suksesshme. /26 Shkurt 2025/
- Delegacioni i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, i udhëhequr nga drejtori Yll Buleshkaj, zhvilloi takime në ANAC në Romë, me mbështetjen e projektit PECK III të Këshillit të Evropës. Diskutimet u fokusuan në transparencë, matjen e korrupsionit, mbrojtjen e sinjalizuesve, prokurimin publik, teknologjitë antikorrupsion, konfliktin e interesit dhe Planin Kombëtar Kundër Korrupsionit. Bashkëpunimi synon shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e mekanizmave institucionalë në Kosovë./27 Shkurt 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përfaqësoi Kosovën në Strasburg në një punëtori të Këshillit të Evropës. APK prezantoi përvojën në hartëzimin e rreziqeve të korrupsionit në 159 institucione publike. Drejtori Yll Buleshkaj theksoi se korrupsioni është sfidë ligjore dhe kulturore që kërkon vullnet institucional, ndërsa ekipi teknik prezantoi zbatimin praktik. Pjesëmarrja e Kosovës u vlerësua si shembull suksesi rajonal dhe evropian./25 Prill 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mirëpriti përfaqësues nga Koreja e Jugut, Mongolia, Uzbekistani, UNDP dhe Ballkani Perëndimor. Vizita u zhvillua në kuadër të forumit “Bashkëpunimi Jug-Jug dhe Trepalësh për Përparimin e Parandalimit të Korrupsionit”. Diskutimet u fokusuan në qasje inovative dhe modele të suksesshme antikorrupsion, përmes sesioneve tematike dhe shkëmbimeve praktike. Forumi forcoi bashkëpunimin ndërkombëtar dhe promovoi integritetin publik dhe transparencën./2 Qershor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit u bë partneri më i ri i rrjetit evropian NEIËA gjatë Asamblesë së 10-të në Bruksel. Drejtori Yll Buleshkaj prezantoi aplikacionin e APK-së dhe theksoi

rëndësinë e integritetit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve në Kosovë. NEIËA ofron një platformë për shkëmbim njohurish dhe përvojash në fushën e integritetit dhe sinjalizimit, në përputhje me Direktivën e BE-së 2019/1937. Ky anëtarësim forcon pozicionin ndërkombëtar të APK-së dhe mekanizmat antikorrupsion./12 Qershor 2025/

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, e përfaqësuar nga Drejtori z. Yll Buleshkaj dhe z. Blerim Kelmendi, mori pjesë në Takimin Plenar të Rrjetit Kundër Korrupsionit (ACN) të OECD-së në Paris. Takimi mbledhi mbi 150 përfaqësues nga institucione shtetërore, organizata ndërkombëtare dhe shoqëria civile për të diskutuar sfidat dhe praktikat më të mira kundër korrupsionit. APK e shfrytëzoi këtë forum për shkëmbim përvojash, dialog rajonal dhe forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke riafirmuar përkushtimin për zbatimin e rekomandimeve./7-9 Korrik 2025/
- Agjencia për Parandalim të Korrupsionit në bashkëpunim me TAIEK, organizoi një trajnim dyditor mbi standardet e BE-së për deklarimin e pasurisë, dhuratat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Trajnimi u ligjërua nga ekspertë ndërkombëtarë dhe synoi avancimin e njohurive mbi praktikat më të mira evropiane. Drejtori Yll Buleshkaj theksoi rëndësinë e forcimit të kapaciteteve profesionale të stafit. APK falënderon Bashkimin Evropian për mbështetjen e vazhdueshme./4-5 dhjetor 2025/

## BASHKËPUNIMI RAJONAL

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës priti një delegacion nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit të Maqedonisë së Veriut. Takimi u fokusua në diskutimin e Memorandumit të Bashkëpunimit, me synim forcimin e koordinimit ndër-institucional kundër korrupsionit. Palët ranë dakord të hartojnë një plan veprimi për shkëmbim përvojash dhe aktivitete të përbashkëta/31 Janar 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mori pjesë në Takimin Rajonal të Komunitetit të Praktikës mbi Integritetin Politik, të mbajtur në Shkup. Agjencia u përfaqësua nga Agron Behrami, Udhëheqës i Divizionit për Verifikim të Pasurisë. Takimi u organizua me mbështetjen e KDI - Transparency International Kosovo, në kuadër të projektit të financuar nga BE “Integrity Éatch”./27 Shkurt 2025/
- Drejtori i APK-së, Yll Buleshkaj, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare në Lubjanë për forcimin e integritetit dhe pavarësisë së drejtësisë penale në Ballkanin Perëndimor. Takimi diskutoi sfidat kryesore, përfshirë vullnetin politik, barazinë gjinore dhe efikasitetin e institucioneve të drejtësisë. Rekomandimet do të shërbejnë si udhërrëfyes për reformat në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe integrimin evropian./10-11 Mars 2025/
- APK mori pjesë në konferencën rajonale për mbrojtjen e sinjalizuesve, organizuar nga IKD, CSDG dhe Koalicioni i Evropës Juglindore. Drejtori Yll Buleshkaj theksoi rëndësinë e sinjalizimit në luftën kundër korrupsionit dhe nevojën për mbrojtje më të fortë ligjore dhe institucionale. APK riafirmoi përkushtimin për integritet dhe transparencë, duke u bazuar në praktikat më të mira dhe direktivat e BE-së./10–11 Prill 2025/
- APK organizoi në Prishtinë një punëtori rajonale në kuadër të projektit PECK III, me mbështetjen e BE-së dhe Këshillit të Evropës. Në aktivitet morën pjesë mbi 80 zyrtarë nga Kosova dhe rajoni, ku u trajtuan deklarimi dhe kontrolli i pasurisë, dhuratat dhe parandalimi i konfliktit të interesit. U shkëmbyen përvoja praktike dhe u diskutua përdorimi i teknologjisë në verifikimin e pasurisë, duke forcuar bashkëpunimin rajonal dhe integritetin institucional./22-23 Maj 2025/

- APK mori pjesë në Punëtorinë Rajonale për Integritetin në Sektorin Publik në Budva, organizuar nga ReSPA, me përfaqësues nga Ballkani Perëndimor dhe Franca. Z. Milot Shala prezantoi gjendjen e integritetit në sektorin publik në Kosovë dhe theksoi rëndësinë e sinjalizimit si mjet për transparencë dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Ai prezantoi edhe aplikacionin ueb dhe mobil të APK-së për sinjalizim dhe kontribuoi në shkëmbimin e përvojave rajonale për përmirësimin e integritetit institucional./25-26 Qershor 2025/
- APK u përfaqësua nga znj. Bleona Krasniqi dhe znj. Edita Rukolli në Shkollën Verore Rajonale për Praktikantët e Rinj Kundër Korrupsionit në Podgoricë, Mali i Zi. Programi i 20-të, i mbështetur nga UNODC dhe Agjencia Austriake për Zhvillim, synon forcimin e kapaciteteve për zbatimin e UNCAC dhe UNTOC përmes shkëmbimit të praktikave dhe rrjetëzimit profesional. /8 Korrik 2025/
- Delegacioni i APK-së, udhëhequr nga Drejtori Yll Buleshkaj, zhvilloi takim në Tiranë me Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë Antikorrupsion në Shqipëri, Insidor Rexhepi. Diskutimi u fokusua në bashkëpunimin ndërinstitucional, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në parandalimin e korrupsionit. Takimin e përshëndeti këshilltarja Silvana Ramadani, duke theksuar rëndësinë e koordinimit institucional dhe politik./16 Shtator 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës realizoi vizitë pune në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit të Malit të Zi për shkëmbim të praktikave më të mira dhe zhvillim të mekanizmave për transparencë dhe integritet. Drejtori Yll Buleshkaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për avancimin e përvojave institucionale, ndërsa u prezantua metodologjia e Këshillit të Evropës për vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni dhe platforma digjitale për raportimin anonim dhe mbrojtjen e sinjalizuesve./26 Shtator 2025/
- Drejtori i APK-së, z. Yll Buleshkaj, përfaqësoi Agjencinë në Samitin e Nivelit të Lartë për Qeverisjen e Mirë dhe Antikorrupsionin në Ballkanin Perëndimor në Sarajevë. Samiti bashkoi institucione, shoqëri civile dhe partnerë ndërkombëtarë për të forcuar luftën kundër korrupsionit dhe avancimin e integritetit evropian në rajon./6 Tetor 2025/
- APK mori pjesë në konferencën rajonale “Preventing Corruption” në Petrovac, Mal të Zi, ku u shkëmbyen përvoja dhe praktika për parandalimin e korrupsionit, forcimin e integritetit dhe dixhitalizimin e shërbimeve. Pjesëmarrja e institucioneve homologe nga rajoni dëshmoi përkushtimin e përbashkët për transparencë dhe integritet institucional. Ngjarja u organizua nga APK Mali i Zi me mbështetjen e UNODC dhe partnerëve rajonalë./28-29 Tetor 2025/
- Drejtori i APK-së, Yll Buleshkaj, mori pjesë në Forumin Rajonal për Integritet dhe Reforma Institucionale në Shkup, ku theksoi rolin e AI-së dhe mjeteve digjitale në luftën kundër korrupsionit. Ai prezantoi angazhimet e APK-së për modernizimin e deklaramentit të pasurisë, raportimin e korrupsionit dhe forcimin e transparencës. Forumi mbledhi ekspertë nga rajoni dhe Evropa, duke dëshmuar përkushtimin për qeverisje të mirë dhe integritet publik./10 Dhjetor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit i Maqedonisë së Veriut nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi. Marrëveshja formalizon shkëmbimin e praktikave më të mira në parandalimin dhe hetimin e korrupsionit, kontrollin e pasurisë e dhuratave dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Memorandumi synon forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës dhe promovimin e qeverisjes së mirë sipas standardeve evropiane./23 Dhjetor 2025/

## Kosova forcon pozicionin e saj në parandalimin e korrupsionit në nivel evropian

Reformat institucionale të Republikës së Kosovës në fushën e parandalimit të korrupsionit janë vlerësuar edhe ndërkombëtarisht gjatë një punëtorie të nivelit të lartë të organizuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), ka prezantuar qasjen dhe përvojën e saj në hartëzimin e rreziqeve të korrupsionit, duke theksuar rëndësinë e këtyre reformave për forcimin e integritetit dhe transparencës në institucionet publike.

Një delegacion ndërkombëtar prej 25 anëtarësh, me përfaqësues nga Koreja e Jugut, Mongolia, Uzbekistani, si dhe nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, me pjesëmarrës nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina pjesë e Punëtorisë për Bashkëpunim Jug-Jug dhe Trepalësh për Avancimin e Parandalimit të Korrupsionit (#SSTC), vizitoi Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), për të mësuar më shumë mbi nismat kundër korrupsionit në Republikën e Kosovës dhe ndërtimin e platformës inovative të raportimit të korrupsionit.









## AKTIVITETET MEDIATIKE

Në funksion të realizimit të mandatit të saj në mënyrë transparente dhe me llogaridhënie të plotë, Agjencia ka intensifikuar veprimet konkrete përmes bashkëpunimit me të gjithë akterët relevantë në fushën e parandalimit të korrupsionit në Kosovë. Dhe gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2025, ka realizuar një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve mediale dhe të vetëdijesimit të publikut të gjerë.

Aktivitetet mediale të Agjencisë gjatë vitit 2025 u fokusuan në komunikimin me mediat, si me pjesëmarrje-organizim të konferencave, intervista e deklarata për media, si dhe pjesëmarrjes në emisione të ndryshme dhe podcaste. Një pjesë e rëndësishme e këtij komunikimi ishte edhe bashkëpunimi me mediat në iniciimin dhe trajtimin e rasteve që lidhen me parandalimin e konfliktit të interesit, procedurat e hetimeve administrative dhe dyshimet për deklarim jo- të saktë të pasurisë. Paralelisht, Agjencia ka siguruar informim të vazhdueshëm të publikut përmes publikimit proaktiv të informatave në ueb-faqen zyrtare të APK-së dhe në rrjetet sociale.

Në vitin 2025 Agjencia organizoi dhe mori pjesë:

- Pjesëmarrje e drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), z. Yll Buleshkaj në konferencën për prezantimin e “Doracakut për Parandalimin e Korrupsionit”.
- Pjesëmarrje e drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), z. Yll Buleshkaj në konferencën mbi Integritetin në Drejtësi.
- Realizim i fushatës informuese për mandatin e APK-së, e transmetuar katër javë në televizionin publik dhe disa herë në rrjete sociale.
- Në kuadër të informimit dhe llogaridhënies publike dhe përgjigjeve në kërkesat e gazetareve gjatë vitit 2025, u realizuan rreth 50 intervista apo prononcime-deklarata dhe pjesëmarrje në emisione televizive dhe podcaste të Drejtorit të Agjencisë.
- Nga 165 përgjigje të ofruara për mediat në vitin 2022 dhe 145 përgjigje në vitin 2023, Agjencia ofroi rreth 140 përgjigje në vitin 2024, ndërsa për periudhën raportuese janar-dhjetor 2025 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) ofroi përgjigje në 120 pyetje të shtruara nga medime të ndryshme.
- Gjatë vitit Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pasur mbulim të qëndrueshëm dhe të kënaqshëm medial, me intensitet më të lartë në periudha të caktuara. Gjatë muajit mars dhe prill, në secilin muaj janë publikuar më shumë se 50 materiale mediatike për APK dhe që kanë cituar APK-në. Ndërsa mbulimi më i madh është shënuar në muajin dhjetor gjatë Javës së Integritetit. Kjo periudhë është karakterizuar me pasqyrim ditor në televizione dhe publikime të shumta në mediat online, duke rezultuar në dhjetëra e qindra artikuj për APK-në.

## AKTIVITETET E VETËDIJËSIMIT TË PUBLIKUT

Me qëllim të informimit të zyrtarëve lidhur me respektimin e obligimeve të përcaktuara me ligj dhe vetëdijesimit të publikut të gjerë, Agjencia ka përgatitur katër (4) videospote vetëdijesuese (të realizuara në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe), për: Mandatin e APK / Thirrje për deklaram të pasurisë / Raportim të konfliktit të interesit / Thirrje për raportim-sinjalizim të rasteve të korrupsionit dhe bashkëpunim institucional.

Këto videospote kanë për qëllim:

- Prezantimin e mandatit dhe rolit të APK-së në parandalimin e korrupsionit.
- Nxitjen e ndërgjegjësimit publik dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në raportimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Videospotet vetëdijesuese janë të publikuara e shfaqen në uebin zyrtar të Agjencisë, kurse janë publikuar disa herë edhe në rrjetet sociale, si dhe transmetuar për disa javë në Radio Televizionin Publik të Kosovës (RTK).

## KËRKESAT PËR QASJE NË INFORMATA PUBLIKE

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia pranoi 17 kërkesa për qasje në dokumente publike, të cilat u trajtuan konform Ligjit. Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Nga gjithsej 17 kërkesa, për 12 nga kërkesat u ofrua qasje e plotë në informacion, në 2 nga kërkesat u ofrua qasje e pjesshme në informacion ndërsa për 3 nga kërkesat bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi u refuzua qasja në informacion.

<b>Trajtimi i kërkesave për Qasje në dokumente publike janar- dhjetor 2025</b>
<b>17</b> kërkesa të pranuar
<b>12</b> qasje e plotë në informacion,
<b>2</b> qasje e pjesshme në informacion
<b>3</b> të refuzuara

Profili i subjekteve që kërkuan qasje në dokumente publike: 6 kërkesa u pranuan nga mediat, 3 kërkesa u pranuan nga Organizata Jo-Qeveritare, 4 kërkesa nga persona privat, dhe 4 kërkesë u pranua nga të tjerë. Ndërsa natyra e kërkesave për qasje ishte si në vijim:

1. Dokumente administrative- 16
2. Dokumente lidhur me marrëdhënien e punësimit -1

## **JAVA E INTEGRITETIT 2025**

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) organizoi me sukses "Javën e Integritetit 2025", një iniciativë e dedikuar forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe ndërtimit të institucioneve me integritet. Kjo javë e aktiviteteve, e zhvilluar nga 8 deri më 12 dhjetor 2025, mblodhi rreth 300 pjesëmarrës nga institucione publike, sektori privat, shoqëria civile dhe media, duke kontribuar në debatin mbi praktikën e mira për luftën kundër korrupsionit.

Gjatë pesë ditëve të aktiviteteve, u mbajtën tryeza diskutimi me tema të ndryshme, duke përfshirë integritetin institucional, sfidat e prokurimit publik, transparencën e zyrtarëve publik për dhurata, parandalimin e konfliktit të interesit dhe rolin e sinjalizimit.

Java e Integritetit 2025 u bë një platformë e suksesshme për debat dhe bashkëpunim për forcimin e transparencës dhe integritetit në institucione. Aktivitetet e mbajtura reflektuan angazhimin e APK-së dhe partnerëve të saj në parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e qeverisjes së mirë.

Me pjesëmarrje të gjerë dhe diskutime të frytshme, ky organizim forcoi bazat për avancimin e politikave të integritetit në Republikën e Kosovës.

Secila ditë e kësaj jave u mbulua gjerësisht nga mediat vizive dhe të shkruara, duke reflektuar interesimin dhe rëndësinë e temave të trajtuara.

### *Dita e Parë: Kontributi i Planeve të Integritetit në Parandalimin e Korrupsionit*

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), në bashkëpunim me Forumin Konsultativ të APK-së me Shoqërinë Civile, më 8 dhjetor hapi aktivitetet e Javës së Integritetit 2025 me panelin e parë tematik, të fokusuar në rëndësinë dhe ndikimin e planeve të integritetit në institucionet publike të Republikës së Kosovës.

Në hapje të ngjarjes, Drejtori i APK-së, z. Ylli Buleshkaj foli për rëndësinë e forcimit të mekanizmave proaktivë për parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e kulturës së përgjegjesisë institucionale.

Ai nënvizoi se Java e Integritetit është tashmë një platformë e rëndësishme vjetore, që synon të ndërjegjësojë opinionin publik dhe të thellojë bashkëpunimin ndërinstytucional në luftën kundër korrupsionit, në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit - 9 Dhjetor.

“Në Kosovë, integriteti i zyrtarëve dhe institucioneve nuk është më opsional - është detyrim ligjor dhe standard profesional”, theksoi Drejtori Buleshkaj në hapjen e Javës së Integritetit 2025.



### *Dita e Dytë: Parandalimi i Korrupsionit në Prokurimin Publik*

Java e Integritetit 2025 vazhdoi punimet më 9 dhjetor me fokus te parandalimi i korrupsionit në prokurimin publik, një nga sektorët më të ndjeshëm ndaj riskut të korrupsionit.

Ngjarja u zhvillua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit dhe synoi të forconte mekanizmat e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në proceset e prokurimit.

Drejtori i APK-së, Yll Buleshkaj, theksoi se integriteti në këtë fushë është “themeli i besueshmërisë së qytetarëve të Kosovës”.

Paneli përfshiu përfaqësues të institucioneve mbikëqyrëse, organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës.

Diskutimet adresuan sfidat kryesore, indikatorët e rrezikut dhe praktikat më të mira për përmirësimin e procesit të prokurimit publik.



#### *Dita e Tretë: Dhuratat në Kryerjen e Funkcionit Zyrtar*

Në kuadër të Javës së Integritetit më 10 dhjetor u zhvillua sesioni tematik i dedikuar menaxhimit të dhuratave në funksionin zyrtar, fushë e ndjeshme dhe e rëndësishme për integritetin institucional dhe parandalimin e ndikimit të papërshtatshëm në vendimmarrjen publike.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Zv. Drejtori i APK-së, z. Liridon Nika, theksoi rëndësinë e trajtimit të duhur të dhuratave në funksionin zyrtar, duke e konsideruar këtë proces një shtyllë të integritetit institucional.

“Një gjest mirësjelljeje. Një simbol kulturor. Por sapo hyn në hapësirën publike, dhurata nuk është më gjest - bëhet test i integritetit tonë dhe i besimit të qytetarëve.”

Pjesëmarrësit diskutuan praktikat më të mira për kontrollin dhe menaxhimin e dhuratave si shtyllë të integritetit institucional dhe qeverisjes së mirë.



*Dita e Katërt: Parandalimi i Konfliktit të Interesit në Arsimin e Lartë*

Në ditën e katërt të Javës së Integritetit, APK organizoi një sesion mbi parandalimin e konfliktit të interesit në arsimin e lartë.

Drejtori i Agjencisë, z. Yll Buleshkaj theksoi rëndësinë e integritetit akademik si shtyllë të cilësisë universitare dhe besimit të shoqërisë.

Diskutimet fokusuan përmirësimin e praktikave institucionale dhe forcimin e besueshmërisë në arsimin e lartë. Sesioni nënvizoi se meritokracia dhe transparenca janë baza e një sistemi arsimor të fortë dhe të drejtë.



#### *Dita e Pestë: Sinjalizimi në Sektorin Publik dhe Privat*

Dita e pestë e Javës së Integritetit 2025, e organizuar Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) në bashkëpunim me Forumin Konsultativ të APK-së me Shoqërinë Civile, u fokusua në një nga mekanizmat kryesorë për forcimin e transparencës dhe mbrojtjen e interesit publik: sinjalizimin në sektorin publik dhe privat.

Në hapje të sesionit tematik, Drejtori i APK-së, z. Yll Buleshkaj, theksoi se sinjalizuesit janë një hallkë e domosdoshme për ruajtjen e integritetit institucional.

“Integriteti i zyrtarëve publik nuk është opsion - është përgjegjësi e përbashkët, dhe sinjalizuesit janë aleatët tanë më të fortë në këtë rrugëtim. Sinjalizimi, në sektorin publik apo privat, është një mekanizëm thelbësor për mbrojtjen e interesit publik dhe për afrim drejt standardeve evropiane”, u shpreh ai.

Sinjalizuesit u konsideruan si hallkë e domosdoshme për ruajtjen e integritetit institucional dhe aleatë të fuqishëm në parandalimin e korrupsionit.



## RRITET BESIMI I QYTETARËVE NDAJ AGJENCISË

Përkushtimi i Agjencisë që ushtrimin e mandatit të saj ta kryej në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të bazuar ekskluzivisht në dispozitat ligjore, por duke qenë e hapur dhe e përgjegjshme në raport me informimin e publikut dhe institucioneve rreth punës dhe fushëveprimit të saj, ka sjell suksese të reja.

Të dhënat e fundit të matjeve të realizuara në muajin dhjetor 2025, tregojnë progres të qartë në rritjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Janë 61% e qytetarëve shumë ose deri diku të informuar për punën e APK-së (+5% krahasuar me qershorin), ndërsa 62% shprehen të kënaqur me performancën e saj (+9% krahasuar me qershorin).

Krahas rritjes së besimit, qytetarët artikulojnë pritshmëri më të larta për verifikim të deklarimeve të pasurisë, trajtim të sinjalizimeve, publikim të të dhënave dhe vetëdijesim publik.

Ky reflektim i pritshmërive do të udhëheq edhe më tutje punën që bën Agjencia, gjithherë në përputhje me standardet evropiane.

## AKTIVITETET EDUKUESE - THEMELIMI I SHKOLLËS DHE TAKIME TË SHUMTA NËPËR KOSOVË

Duke e vlerësuar edukimin si mjet apo investim afatgjatë për parandalimin e korrupsionit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), ka zhvilluar një sërë aktivitetesh me gjeneratat e reja, respektivisht me nxënës të shkollave të mesme dhe studentë.

Si rezultat i bashkëpunimit me Organizatat Jo-Qeveritare, mbështetur edhe nga partnerët ndërkombëtar, Drejtori i APK-së sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Agjencisë me Organizatën Jo-Qeveritare Democracy Plus, gjatë vitit 2025 ka shkuar një hap tutje në edukimin qytetar, me theks gjeneratat e reja - studentët.

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në bashkëpunim me Democracy Plus dhe me mbështetjen e Fondit të Kanadasë për Iniciativa Lokale (CFLI), **themeloi Shkollën për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit**. Programi synon fuqizimin e të rinjve përmes njohurive dhe aftësive praktike në fushën e integritetit dhe parandalimit të korrupsionit, duke ofruar mundësi për punë praktike profesionale në APK për pjesëmarrësit më të dalluar./11 Gusht 2025/.

Në këtë aktivitet edukues, respektivisht sesionin e parë të Shkollës për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit, kanë aplikuar 79 studentë nga e gjithë hapësira e Kosovës, ndërsa kanë plotësuar kriteret dhe kanë kaluar testet për të ndjekur ligjëratat 25 studentë. Prej atyre që kanë ndjekur shkollën, 4 studentë më të dalluar janë angazhuar për tre muaj me punë praktike në Agjenci, duke u paguar me pagë mujore nga donatorët.

Agjencia ka zhvilluar gjatë vitit 2025 edhe aktivitete vetëdijësuese të tjera me nxënës të shkollave të mesme dhe studentë në kryeqytet dhe qytete të tjera të Kosovës:

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit zhvilloi ligjëratë-diskutim me studentët e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës. Drejtori i APK-së, z. Yll Buleshkaj prezantoi mandatin e Agjencisë dhe shpjegoi procesin e deklarimit të pasurisë, kontrollin e dhuratave dhe parandalimin e konfliktit të interesit./30 Prill 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) realizoi ligjëratë-diskutim me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës. Zëvendësdrejtori z. Liridon Nika prezantoi mandatin e Agjencisë, ndërsa Afrim Atashi dhe Esad Ejupi shpjeguan aspektet praktike të deklarimit të pasurisë, dhuratave dhe parandalimin e konfliktit të interesit./15 Maj 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mbajti një bashkëbisedim me nxënësit e Gjimnazit "Ahmet Gashi" në Prishtinë. Gjatë takimit u diskutua për transparencën, integritetin dhe rolin e të rinjve në parandalimin e korrupsionit./30 Maj 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mirëpriti pjesëmarrësit e Shkollës së organizuar nga KDI – GO4IT, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Ambasada Suedeze në Kosovë. Drejtori i APK-së, Yll Buleshkaj, prezantoi mandatin dhe rolin e APK-së, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në forcimin e integritetit dhe transparencës./12 Gusht 2025/

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit zhvilloi një bashkëbisedim me maturantët e Gjimnazit “Aleksandër Xhuvani”, në Podujevë, ku u diskutua mbi misionin e saj, rëndësinë e integritetit dhe rolin e të rinjve në parandalimin e korrupsionit. Zyrtarët e APK-së inkurajuan të rinjtë që të kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhme më të drejtë dhe institucione më të forta./12 Shtator 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit realizoi ligjëratë-diskutim me gjimnazistët e Shkollës “Dr. Shaban Hashani”, në Ferizaj, me ç’rast përfaqësuesit e Agjencisë bashkëbiseduan me të rinjtë mbi rëndësinë e integritetit dhe rolin e tyre në parandalimin e korrupsionit. Nxënësit u angazhuan me pyetje dhe diskutime, duke theksuar se edukimi mbi integritetin fillon me vetëdijësimin e brezit të ri./23 tetor 2025/
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), në bashkëpunim me Demokraci Plus, organizoi për të rinjtë e Shkollës për Integritet dhe Parandalim të Korrupsionit një vizitë studimore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP). Pjesëmarrësit u informuan për mandatin, bazën ligjore dhe praktikën e AIP-së në mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike, duke u theksuar rëndësia e transparencës dhe integritetit institucional./27 Nëntor 2025/

## TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË JASHTËM

Në bazë të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-085 Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, theksohet e drejta e sinjalizuesve për të bërë sinjalizim të jashtëm pasi kanë kryer sinjalizimin e brendshëm, apo edhe drejtpërdrejtë sinjalizim të jashtëm, Procedura për sinjalizim të jashtëm për sektorin publik inicihet me raportimin e informacionit tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka pranuar dhe evidentuar gjithsej 92 raste të sinjalizimit të jashtëm.

Nga 20 raste të pranuar në vitin 2023, numri ka arritur në 48 raste në vitin 2024, ndërsa gjatë vitit 2025, ka arritur në 92 raste, që tregon se numri i rasteve të përfunduara në vitin 2025, është rritur me rreth 91.7% krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje mund të interpretohet si një shenjë pozitive për kulturën e sinjalizimit dhe besimin që qytetarët kanë për të raportuar aktivitete të dyshimta ose të paligjshme, duke u mbështetur në mbrojtjen që ofron Ligji për Sinjalizuesit.

Kjo rritje e rasteve tregon gjithashtu që ka pasur një angazhim më të madh të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, në vetëdijësimin e zyrtarëve publik rreth mekanizmit të sinjalizimit, e që si rezultat i kësaj ka pasur në të njëjtën kohë edhe rritje të besueshmërisë në Agjenci.

Ky trend mund të ketë edhe disa implikime të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit dhe transparencën në Institucionet publike. Është gjithashtu një tregues i rëndësishëm i rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me mundësitë dhe mbrojtjen që ofrohet për sinjalizuesit, si dhe i forcimit të besimit në mekanizmat ligjorë që mbështesin këtë praktikë.

**Rastet e përcjella në Gjykatën për Kundërvajtje**, 4 raste janë përcjellë në Gjykatë, për arsye që raportet e sinjalizuesve nuk janë pranuar dhe trajtuar sipas detyrimeve ligjore, si dhe për shkak se janë marrë masa kundër sinjalizuesve, në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve

**Rastet e përcjella në Prokurorinë e Shtetit**, 3 rastet janë përcjellë si Informata për shkak të dyshimit të arsyeshëm që ka pasur elemente të veprave penale dhe të njëjtën kohë për të vlerësuar nëse ekzistojnë prova të mjaftueshme apo duhet të sigurohen prova tjera, në mënyrë që të vazhdoen procedurat tjera të mëtejshme ligjore.

**Rastet e përcjella në Policinë e Kosovës, Departamenti për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion**, 7 raste janë përcjellë në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar nëse duhet të fillojë ndonjë hetim eventual penal apo duhet të sigurohen prova tjera për të proceduar më tutje.

**Rastet e përcjella në Institucionet Publike**, 31 raste janë dërguar te Institucionet tjera publike të konstatuara si kompetente nga ana e Agjencise, prej te cilave është kërkuar që të vlerësojnë pretendimet e paraqitura dhe të ndërmarrin masa për to, këto Institucione janë:

- Administrata Tatimore e Kosovës: (2 raste),
- Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave: (1 rast)
- Akademia e Kosovës për Siguri Publike (3 raste),
- Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës: (1 rast)
- Inspektorati Policor i Kosovës: (2 raste),
- Inspektorati Qendror i Punës: (1 rast)
- Komuna e Mitrovicës së Jugut: (1 rast),
- Komuna e Obiliqit: (2 raste),
- Komuna e Prishtinës: (3 raste),
- Korporata Energjetike e Kosovës- KEK: (1 rast),
- Kuvendi i Republikës së Kosovës: (1 rast),
- Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit: (1 rast),
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve: (1 rast),
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë: (1 rast),
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit: (1 rast),
- Ministria e Punëve të Brendshme: (3 raste),
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporë: (1 rast),
- Ministria e Shëndetësisë: (1 rast),
- Qendra e Mjekësisë Familjare ne Ferizaj: (1 rast),
- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës: (2 raste),
- Universiteti i Prishtinës: (1 rast),

**Rastet e mbyllura dhe refuzuara:** 17 raste prej numrit total të rasteve, gjatë këtij viti janë MBYLLUR, pasi që pas zhvillimit të procedurës së hetimit administrativ dhe provave të shqyrtuara, nuk janë vërtetuar pretendimet e paraqitura nga ana e sinjalizuesve.

Rastet e mbyllura zakonisht në ndervete kanë ngërthyer pretendime të mangëta, të cilat nuk kanë pasur ndonjë provë bindëse dhe të arsyeshme.

## TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM

Punëdhënësi publik i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar, dhe punëdhënësi privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës.

Nga 210 institucione publike për të cilat Agjencia ka të dhëna që kanë caktuar zyrtarin përgjegjës, raportin në Agjenci e kanë përcjellë 189 institucione, pjesa dërmuese e tyre e kanë përcjellë gjatë afatit të paraparë ligjor, një numër i vogël i tyre i ka përcjellë edhe gjatë muajit shkurt të këtij viti.

Përderisa, 20 institucione publike nuk e kanë dërguar këtë raport në adresë të Agjencisë. Me kërkesë të Agjencisë, zyrtarët përgjegjës kanë organizuar aktivitete vetëdijesuese brenda institucioneve të tyre, dhe si rezultat i kësaj gjatë vitit 2025, 65 institucione publike na kanë dëshmuar organizimin e aktiviteteve të tilla.

Agjencia pritet që të organizojë aktivitete brenda Institucioneve publike me zyrtarët përgjegjës, do të organizojë aktivitete për zyrtarët e rinj si dhe gjithashtu për sektorin privat, të gjitha këto me qëllim të vetëdijesimit për mekanizmin e sinjalizimit. Gjatë vitit 2025, janë dalluar tre institucione me numrin më të madh të raportimeve të sinjalizimit, të cilat janë: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar, Korporata Elektroenergjitike e Kosovës dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Ndërsa numri total i raportimeve në kuadër të sinjalizimit të brendshëm për vitin 2025, ka qenë 130 raste.

Sa i përket subjekteve private, gjatë këtij viti Agjencia ka ndërmarr veprime konkrete, duke siguruar fillimisht të dhënat në Administratën Tatimore të Kosovës, për subjektet private me mbi 50 të punësuar, nga të cilët pastaj kemi kërkuar të raportojnë në Agjenci dhe njëkohësisht të caktojnë zyrtarin përgjegjës të tyre.

Nga përgjigjet e marra nga subjektet private, pozitivisht në raportim për vitin 2025, janë përgjigjur 349 subjekte private, të cilat kanë raportuar lidhur me rastet e sinjalizimit për vitin 2025. Caktimi i zyrtareve përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit në kuadër të subjekteve private, shënon një hap të duhur për zbatimin e mekanizmit të sinjalizimit në përgjithësi.

Ndërsa vetëm 3 subjekte private kanë raportuar që kanë pranuar raste të kësaj natyre: IPKO Telecommunication LLC (2 raste), TEB Bank (1 rast) si dhe Sutherland Global Services (1 rast)




Figura 6. Paraqitja grafike e institucioneve me numrin më të madh të sinjalizimeve gjatë vitit 2025

## AKTIVITETE/TRAJNIME ME ZYRTARË PËRGJEGJËS

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është e përkushtuar të investojë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve përgjegjës në fushën e sinjalizimit, përmes organizimit të trajnimeve dhe aktiviteteve informuese. Këto aktivitete synojnë që zyrtarët të pajisen me njohuritë e nevojshme për zbatimin e duhur të mekanizmave të mbrojtjes së sinjalizuesve brenda institucioneve publike.

Trajnimet përbëjnë një element kyç të përpjekjeve të Agjencisë për të forcuar aftësitë praktike dhe profesionale të zyrtarëve që trajtojnë rastet e sinjalizimit, duke siguruar veprim në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare. Në kuadër të këtyre trajnimeve janë trajtuar temat në vijim:

- **Njohja me Ligjin dhe Procedurat e Sinjalizimit:** Trajnimi i zyrtarëve lidhur me kornizën ligjore dhe procedurat që duhet të zbatohen gjatë pranimit dhe trajtimit të sinjalizimeve, si dhe me standardet për menaxhimin e rasteve që lidhen me sinjalizuesit.
- **Trajtimi i Rasteve të Sinjalizimit:** Forcimi i aftësive profesionale për vlerësimin, analizimin dhe shqyrtimin e rasteve të sinjalizimit, duke garantuar një proces të drejtë, transparent dhe mbrojtës ndaj sinjalizuesve.

- **Rëndësia e Transparencës dhe Llogaridhënies:** Ndërgjegjësimi dhe trajnimi i zyrtarëve mbi rolin e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike, si dhe mbi ndikimin e sinjalizimit në parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike.
- **Menaxhimi i Informacioneve Konfidenciale:** Edukimi i zyrtarëve mbi përdorimin e praktikave dhe mjeteve teknologjike për ruajtjen dhe mbrojtjen e informacioneve të sinjalizuara, duke garantuar sigurinë e të dhënave dhe konfidencialitetin e identitetit të sinjalizuesve.
- **Mbrojtja e Sinjalizuesve:** Trajnimi i zyrtarëve lidhur me mekanizmat dhe masat mbrojtëse për sinjalizuesit, me qëllim parandalimin e hakmarrjes, diskriminimit apo ndëshkimeve të mundshme pas paraqitjes së një sinjalizimi.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka mbajtur gjithsej 16 aktivitete, të gjitha të dedikuara për zyrtarët përgjegjës të institucioneve publike. Nga këto aktivitete, 4 kanë qenë **trajnime të avancuara**, të organizuara me qëllim të thellimit të njohurive profesionale, forcimit të kapaciteteve institucionale dhe avancimit të aftësive praktike të zyrtarëve përgjegjës në fushën e parandalimit të korrupsionit dhe zbatimit të legjislacionit përkatës. Në disa nga këto trajnime, Agjencia është mbështetur nga OSCE – Misioni në Kosovë, dhe ato janë realizuar në këto data:

- 08 Prill 2025: (Vendi: zyrat e APK),
- 16 Prill 2025: (Vendi: zyrat e APK),
- 24 Prill 2025: (Vendi: zyrat e APK),
- 26-27 Maj 2025: (Vendi: Hotel Dukagjini- Pejë),
- 28-29 Maj 2025: (Vendi: Hotel Dukagjini- Pejë),
- 17-18 Qershor 2025: (Vendi: Hotel Dukagjini- Pejë),
- 19-20 Qershor 2025: (Vendi: Hotel Dukagjini- Pejë),
- 14-15 Gusht 2025: (Vendi: Hotel Astoria-Gjilan),
- 21-22 Nëntor: (Vendi: Premium Park Hotel-Prizren),
- 12 Dhjetor 2025: (Vendi: Hotel Sirius).

Përmes këtyre trajnimeve, Agjencia synon të forcojë kulturën e sinjalizimit të sigurt dhe të besueshëm, duke kontribuar në parandalimin e korrupsionit dhe në avancimin e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë institucionale. Njëkohësisht, këto aktivitete shërbejnë për rritjen e vetëdijes së zyrtarëve publikë mbi rëndësinë e rolit të tyre në mbrojtjen e sinjalizuesve dhe në ndërtimin e besimit të publikut në institucionet publike.

**Disa foto nga aktivitetet****MËSIMET E NXJERRA DHE PRIORITETET NË TË ARDHMEN**

Menaxhmenti i Agjencisë edhe gjatë vitit 2025 ka vazhduar të përqendrojë angazhimin e tij në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, duke garantuar paanshmëri dhe trajtim të barabartë në ushtrimin e mandatit dhe kompetencave ligjore. Ky përkushtim ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e besimit të publikut ndaj Agjencisë. Numri i konsiderueshëm i raportimeve të pranuar për deklarim të pasaktë të pasurisë, konflikt të mundshëm të interesit apo shkelje të tjera që cenojnë interesin publik – të paraqitura nga qytetarë, grupe interesi, institucione dhe zyrtarë të lartë shtetërorë – dëshmon rritjen e vetëdijes qytetare dhe gatishmërinë për të kontribuar në luftën kundër korrupsionit.

Sensibilizimi i zyrtarëve publikë në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit ka qenë një ndër prioritetet kryesore gjatë vitit 2025. Rritja e numrit të kërkesave për trajtimin e situatave të konfliktit të interesit tregon besimin e shtuar në punën e Agjencisë. Megjithatë, hezitimi i disa autoriteteve përgjegjëse

për t'i trajtuar këto raste reflekton nevojën për angazhim më të madh institucional në zbatimin dhe monitorimin e procedurave përkatëse. Pavarësisht fushatave sensibilizuese dhe trajnimeve të vazhdueshme, Agjencia synon ngritjen e mëtejshme të standardeve të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së zyrtarëve publikë, në mënyrë që ata vetë të identifikojnë, trajtojnë dhe shmangin situatat e konfliktit të interesit gjatë procesit të vendimmarrjes, pa pasur nevojë për ndërhyrje të drejtpërdrejtë nga Agjencia.

Procesi i sistematizimit dhe riorganizimit të brendshëm, në përputhje me mandatin dhe kompetencat ligjore, ka mundur shpërndarje më efikase të burimeve njerëzore dhe menaxhim më të mirë të detyrave dhe përgjegjësisë. Gjatë vitit 2025 është realizuar plotësimi i pozitave të parapara sipas strukturës organizative, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe në forcimin e performancës institucionale. Konsolidimi i strukturës së personelit ka kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe në përmbushjen më të plotë të detyrimeve ligjore të Agjencisë.

Zbatimi dhe avancimi i sistemit elektronik për deklarimin e pasurisë dhe dorëzimin online ka ndikuar në rritjen e transparencës, saktësisë dhe efikasitetit të procesit të monitorimit dhe verifikimit. Transformimi digjital i Agjencisë gjatë vitit 2025 ka përbërë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit institucional, duke përmirësuar menaxhimin e të dhënave dhe duke lehtësuar qasjen e qytetarëve në shërbimet elektronike, përfshirë raportimin e rasteve. Në vijim, prioritet mbetet integrimi i sistemeve të Agjencisë me platformat e institucioneve të tjera shtetërore, si mundësi efektive për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave nga burime të shumta, me qëllim identifikimin më të shpejtë dhe të saktë të shkeljeve të mundshme.

Agjencia ka vepruar në mënyrë të vazhdueshme për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, duke qenë e hapur dhe e përgjegjshme në informimin e publikut dhe institucioneve për aktivitetet dhe rezultatet e saj. Bashkëpunimi me institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat ka forcuar besimin dhe ka dëshmuar përkushtimin e saj ndaj një komunikimi të hapur. Publikimi i rregullt i aktiviteteve, lansimi i audiove vizuale për përdorimin e platformës "Raporto Korrupsionin", pjesëmarrja në media, konferenca dhe intervista, si dhe përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare, kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të publikut.

Në vazhdim, prioritet mbetet organizimi i aktiviteteve vetëdijësuese për qytetarët lidhur me korrupsionin dhe ndikimin e tij në shoqëri, përmes fushatave edukative, mediave sociale, pjesëmarrjes në emisione dhe formave të tjera të komunikimit publik. Përmirësimi i komunikimit me mediat dhe publikun konsiderohet thelbësor për rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit në rezultatet e punës së Agjencisë.

Hartimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i akteve nënligjore në përputhje me standardet ligjore ka qenë një proces i rëndësishëm gjatë vitit 2025. Aktet e miratuara kanë ndihmuar në strukturimin e një baze të qëndrueshme për zbatimin efektiv të legjislacionit. Në vijim, mbetet prioritet harmonizimi i legjislacionit

sekondar me atë primar, duke iu përshtatur nevojave institucionale dhe duke siguruar funksionim më efikas të proceseve të punës.


Rritja e numrit të rasteve të sinjalizimit gjatë vitit 2025 dëshmon besimin e shtuar në mekanizmat përkatës. Trajnimet e zyrtarëve përgjegjës brenda institucioneve kanë kontribuar në përmirësimin e performancës dhe në forcimin e përgjegjësisë në trajtimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Prioritet mbetet krijimi i një ambienti të sigurt dhe mbrojtës për sinjalizuesit, duke e konsideruar mbrojtjen e tyre si një mekanizëm të rëndësishëm parandalues kundër korrupsionit dhe si faktor kyç në forcimin e integritetit institucional.

Agjencia synon që përmes forcimit të ekspertizës profesionale dhe shtimit të kapaciteteve, vlerësimit të rrezikut të korrupsionit në sektorë të ndryshëm, adresimit të zbrazëtirave ligjore dhe monitorimit të planeve të integritetit, të kontribuojë në mënyrë të qëndrueshme në parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

Nevojat e identifikuar gjatë zbatimit të Planit Vjetor të Performancës për vitin 2025 janë mbështetur nga partnerë të ndryshëm përmes projekteve konkrete. Forcimi i këtij bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Gjatë vitit 2025, Agjencia ka zhvilluar bashkëpunim të suksesshëm me partnerë ndërkombëtarë, duke marrë pjesë në aktivitete brenda dhe jashtë vendit dhe duke shkëmbyer praktika më të mira në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Përfaqësimi në iniciativa rajonale dhe globale do të mbetet prioritet strategjik.

Një prioritet me rëndësi të veçantë mbetet angazhimi i të gjitha institucioneve përgjegjëse për fuqizimin e autoriteteve kompetente në parandalimin e konfliktit të interesit, zyrtarëve kontaktues për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave, si dhe zyrtarëve përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve. Krijimi i kushteve adekuate të punës për këta zyrtarë, si pika kyçe kontakti dhe koordinimi me Agjencinë, është thelbësor për zbatimin efektiv të detyrimeve ligjore në fushën e parandalimit të korrupsionit.

SHTOJCA NR. 1. ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)



SHTOJCA NR.2. LISTA E PJESËMARRJES NË TRAJNIME, FORUME, SEMINARE GJATË VITIT 2025

Nr.	Lloji i Trajnimit	Organizon	Vendi	Data	Nr. PPjesëmarrësve
1.	Prezantimi dhe diskutimi rreth Udhëzuesit Metodologjik për Konfliktin e Interesave	APK	Istog	29-31.01.2025	14
2.	Zyrtarët shpenzues	Thesari i Kosovës	Prishtin	06.02./2025	1
3.	Vizitë studimore, mekanizmat vendor kundër Korrupsionit	EPAC	Lisbonë	11-13.02.2025	3
4.	Vizitë zyrtare në AKK-ë të Francës	EPAC	Paris	19-21.02.2025	3
5.	Pjesëmarrje në takimin rajonal të komunitetit të praktikës mbi Integritetin Politik në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi	Instituti Demokratik Kosovës	Shkup	27-28.02.2025	1
6.	Vizitë studimore	PECK III	Romë	25.02.2025-1.03.2025	11
7.	modulin e zotimeve	Thesari i Kosovës	Prishtin	05-10.03.2025	1
8.	Modulin e Shpenzimeve/ Certifikues	Thesari i Kosovës	Prishtin	13-17.03.2025	1
9.	Microsoft Visio & Microsoft Publisher	IKAP	Prishtin	27-28.03.2025	2
10.	Mbrojtja e të Dhënave Personale	IKAP	Prishtin	27-28.03.2025	1
11.	Rritja e mbikëqyrjes publike dhe logaridhënës Institucionale në Kosovë	GLPS	Prishtin	20.03.2025	1
12.	Transferimi, pezullimi dhe rëfudimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil.	IKAP	Prishtin	25-26.09.2025	1
13.	Pjesëmarrje në grupin punues për Integritetin Publik dhe kundër Korrupsionit	OECD	Paris	25-28.03.2025	2
14.	Konferencë Evropiane për Sinjalizim	Instituti Evropian për Sinjalizim	Bruksel	03-04.04.2025	1
15.	Avancimi i Sistemit të Deklarimit të pasurisë	APK	Prishtin	22.04.2025	17
16.	Ekzekutimi i buxhetit dhe procedurat e rrisjes së shërbimit	Thesari i Kosovës	Prishtin	22-23.04.2025	3
17.	Punëtori për hartimin e Metodologjisë për Monitorimin e Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit	APK/ OSCE	Gjakovë	19-21.05.2025	12

18.	Mekanizmi i Sinjalizimit- Trajnim i avancuar	APK/OSBE	Pejë	19-20.06.2025	7
19.	Parandalimi dhe Zvogëlimi i Barrës administrative	BE	Prishtin	28-30.05.2025	4
20.	Hyrje në mekanizmat e shqyrtimit të NCAC dhe UNTOC	RAI	Podgori	01-04.07.2025	2
21.	Mbështetje për proceset e reformës së integritetit në BE të Kosovës me mandat nga Ministria Federale Gjermane për bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim	IKAP	Prishtin	07-08.07.2025	1
22.	Pjesëmarrje në takimin e 24-të të monitorimit të Planit të Veprimit kundër korrupsionit	OECD	Paris	07-10.07.2025	2
23.	Trajnimin për regjistrim të pasurive në MFK	Thesari i Kosovës	Prishtin	08-11.07.2025	1
24.	Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-97 për Zyrtarët Publikë.	MPB	Prishtin	23.07.2025	1
25.	Parandalimi i Korrupsionit përmes Sinjalizimit dhe Integritetit në Sektorin Publik	APK/OSCE	Gjilan	14-15.08.2025	2
26.	Takim në mes të APK-së dhe ANAC	OSCE	Romë	14-16.09.2025	3
27.	Programin e Avancuar Profesional për Rroqurim Publik	IKAP	Prishtin	23.09.2025	1
28.	Transferimi, pezullimi dhe përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil	IKAP	Prishtin	25-26.09.2025	1
30.	Vizitë zyrtare në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në Mal të Zi	Agjencia e Malit të Zi	Podgori	26.09.2025	8
31.	Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme pa nderim	BE	Prishtin	30.09.2025-1.10.2025	4
32.	Anti-Korrupsioni dhe Qeverisja e mirë në Ballkanin Perëndimor	RAI	Sarajev	05-07.10.2025	1
33.	Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit (MSA)”.	IKAP	Prishtin	15-16.10.2025	1
34.	Çështjet gjinore dhe sfidat e ndërtimit të arazisë gjinore	IKAP	Prishtin	20 -21.10.2025	1
35.	Hyrje në legjislacion – Teoria e Përgjithshme e akteve juridike	IKAP	Prishtin	22-23.10.2025	1
36.	Sistemi i menaxhimit të performances dhe mbikëqyrja e agjencive	IKAP	Prishtin	03-04.11.2025	2
37.	Raporti Përmbledhës mbi Zbatimin e Planeve të Integritetit (janar-qershor) si dhe mandamentimi i Udhëzuesit për Monitorim dhe Raportim të Planeve të Integritetit	APK/OSCE	Podujev	09-11.10.2025	14

38.	Trajnim për Trajner	IKAP	Prishtin	18.11.2025	1
39.	Pjesëmarrës në tryezën: Komuniteti rajonal i Praktikës për Integritetin në Sektorin Publik	AFA/ RESPA	Beograd	21-23.10.2025	2
40.	Konferenca Profesionale dhe Kuvendi i Përgjithshëm vjetor të 24-të të EPAC/EACN	EPAC/EACN	Hagë	23-26.11.2025	2
41.	Punëtori për finalizimin e Planit të Performances për APK-në për vitin 2026	APK	Tiranë	04-06.11.2025	20
42.	Rëndësia e parandalimit të konfliktit të interesit në burim	OSBE	Pejë	11-13.11.2025	4
43.	Mbrojtja e Sinjalizuesve në Praktikë	OSCE	Prizren	21-22.11.2025	2
45.	Plani Strategjik i APK-së për vitet 2026-2028	OSCE	Pejë	01-03.12.2025	16
46.	Zhvillimi i Mekanizmave të Kontrollit dhe Digjitalizimi i Proceseve në Sistemin e Menaxhimit të Financave Publike	Thesari i Kosovës	Prishtin	04.12.2025	1
47.	Punëtorinë e organizuar me mbështetjen SIGMAs për forcimin e rolit strategjik të JMBNJ	DMZP	Prishtin	18.12.2025	1